



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 250 Akti

Nr. 309 Vendimi  
Tiranë, më 16.10.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Firdes Shuli</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në datën 7.10.2020 ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Flora Hajredinaj**, gjyqtare në Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, vëzhguesen ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), më 15.1.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykes, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykes nr. 1, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektshi, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.

3. Me vendimin nr. 1, datë 18.1.2019, trupi gjykes vendosi fillimin e hetimit administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Flora Hajredinaj, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykes komisioneren Brunilda Bektshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykes, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhguese ndërkombëtare për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Mia Roessingh.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe grupi i punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

5. Trupi gjykes, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 18.5.2020 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht si dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 18.5.2020 mbi përbërjen e trupit gjykes, mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykes.

7. Komisioni, në datën 1.6.2020, nëpërmjet postës elektronike ka njoftuar përsëri subjektin e rivlerësimit duke i kujtuar afatin e kthimit të përgjigjeve të rezultateve të hetimit deri më 15.6.2020.

8. Subjekti i rivlerësimit në datën 5.6.2020, nëpërmjet postës elektronike ka njoftuar Komisionin, duke paraqitur një kërkesë, në të cilën kërkon deklasifikimin e plotë të informacionit të DSIK-së.

9. Subjekti i rivlerësimit në datën 10.6.2020, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar nga Komisioni shtyrje të afatit të kthimit të përgjigjeve për shkak të paaftësisë së përkohshme për punë, duke bashkëngjitur raportin përkatës, ku i jepej 14 ditë pushim deri më 25.6.2020.

10. Komisioni në datën 15.6.2020 pranoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke i dhënë një afat të ri për kthimin e përgjigjeve të rezultateve të hetimit deri më 30.6.2020. Gjithashtu, Komisioni ka sqaruar subjektin lidhur me kërkesën e datës 5.6.2020, në lidhje me raportin e DSIK-së, ku ka shpjeguar se për kriterin e kontrollit të figurës i ka vënë në dispozicion raportet e deklasifikuara të DSIK-së dhe se është kjo e fundit autoriteti që bën klasifikimin/deklasifikimin e raportit.

11. Subjekti i rivlerësimit në datën 25.6.2020, ka kërkuar përsëri nga Komisioni shtyrje të afatit për kthimin e përgjigjeve të rezultateve të hetimit, pasi vijon me gjendje jo të mirë shëndetësore, duke bashkëngjitur raportin për paftësi të përkohshme në punë me regjim shtrati, ku i jepen 7 ditë pushim deri më 2.7.2020.

12. Komisioni në datën 30.6.2020, nëpërmjet postës elektronike ka njoftuar subjektin për pranimin e kërkesës duke i dhënë një afat të ri për kthimin e përgjigjeve të rezultateve të hetimit deri më 8.7.2020.

13. Subjekti i rivlerësimit në datën 1.7.2020, ka kërkuar përsëri nga Komisioni shtyrje të afatit të kthimit të përgjigjeve të rezultateve të hetimit për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore dhe shtrimit në spital duke bashkëngjitur vërtetim përkatës nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”.

14. Komisioni në datën 7.7.2020, nëpërmjet postës elektronike ka vendosur të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit.

15. Komisioni në datën 1.9.2020, nëpërmjet postës elektronike i ka njoftuar subjektit të rivlerësimit afatin e ri për kthimin e përgjigjeve për rezultatet e hetimit jo më vonë se data 10.9.2020.

16. Subjekti i rivlerësimit në datën 10.9.2020, nëpërmjet postës elektronike dhe fizikisht ka dërguar përgjigjet e rezultateve të hetimit, si dhe provat në funksion të tyre.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 1.10.2020.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 7.10.2020, ora 9:30, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh.

19. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, u paraqit personalisht, parashtrori shpjegimet e saj, si dhe i depozitoi me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

20. Znj. Flora Hajredinaj ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**21.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**22.** Për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**23.** Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**24.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.6.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, e cila është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2010, me numër indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**25.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

##### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**26.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, drejtoritë vendore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj.;
- d) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

**27.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

**28.** Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2 (në vazhdim – deklarata *Vetting*), në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ **Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting***

Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

**1. Apartament banimi me sip. 119.56 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, blerë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2006. Vlera: 81,000 euro. Pjesa takuese “në bashkëpronësi”.**

**Burimi i krijimit:** (a) kursimet bashkëshortore për periudhën janar 2004 – gusht 2006, në shumën 1,650,000 lekë; (b) shuma 40,000 euro, dhuratë bashkëshortit nga babai i tij, në vitin 2005; (c) shuma 4,813,000 lekë kredi në “Raiffeisen Bank”, prej të cilave shuma 9,500 euro mbetet gjendje pas investimeve plotësuese në banesë.

**1.1** Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2006 ( në vijim DIPP), subjekti ka deklaruar: “*Blerë apartament banimi në rrugën ‘\*\*\*’, përballë restorant ‘\*\*\*’, pallat i ri në sipërfaqen 130 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2006, në vlerën 81,000 euro. Vlera e apartamentit është paguar e gjitha dhe aktualisht është i peregjistruar*”.

Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Gjatë vitit 2013 ka përfunduar regjistrimi i apartamentit të blerë në vitin 2006 me certifikatën e vërtetimit të pronësisë, datë 14.1.2013*”.

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon në ILDKPKI.

**1.2** ASHK-ja Tiranë<sup>2</sup> ka konfirmuar regjistrimin në bashkëpronësi të subjektit Flora Hajredinaj me bashkëshortin K.H., të pasurisë së llojit “apartament” me sip. 119.56 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

**1.3** Apartamenti me sip. 119.56 m<sup>2</sup>, fillimisht është përfituar me kontratën e sipërmarrjes, datë 1.8.2006<sup>3</sup>, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositëse Flora Hajredinaj për ndërtimin e apartamentit me sip. 130 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me çmimin total 81,000 euro, shumë e cila do të likuidohet si vijon: kësti i parë prej 51,000 euro likuiduar porositësit para përpilimit të kontratës jashtë zyrës noteriale; diferenca e çmimit prej 30,000 euro do t'i likuidohet sipërmarrësit brenda datës 10.9.2006.

**1.4** Subjekti, në datën 20.12.2012, ka lidhur kontratën e shitblerjes<sup>4</sup> për apartamentin me sipërfaqe totale 132.61m<sup>2</sup> ( sipërfaqja e përbashkët 13.13 m<sup>2</sup>) me vlerë 81,000 euro, likuiduar tërësisht me kontratën e sipërmarrjes së datës 1.8.2006.

**1.5** Subjekti ka depozituar mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 31.8.2006, ku rezulton se znj. Flora Hajredinaj ka paguar shumë 30,000 euro me shënimin “*likuidimi u krye i plotë për apartamentin*”, ndërsa kësti prej 51,000 euro i është likuiduar porositësit para përpilimit të kontratës jashtë zyrës noteriale deklaruar ky fakt në kontratën e sipërmarrjes.

**1.6** Komisioni ka analizuar çmimin e pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes, datë 1.8.2006, në shumë 81,000 euro, duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së për vitin 2006 dhe konkretisht udhëzimit përkatës<sup>5</sup>, ku përcaktohet se të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në Tiranë janë në vlerën 79,615 lekë/m<sup>2</sup>. Duke llogaritur sip.132.61 m<sup>2</sup> x 79,615 lekë = 10,557,745 lekë = 86,652 euro.

**1.7** Komisioni, me pyetësorin nr. 3, ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime në lidhje me mobilimin e apartamentit.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se apartamenti është blerë dhe arreduar dhe se vlera e arredimit është përfshirë në çmimin e blerjes. Në kontratën e sipërmarrjes, janë specifikuar punimet që ka bërë firma e ndërtimit në total, ku përveç zërave që lidhen me ndërtimin si pllaka, lysterje etj., janë specifikuar kryesisht të dhëna në lidhje me pajisjet hidrosanitare, si dhe një oxhak, hidromasazh, një kondrabufe etj. Ndërkohë, sendet e tjera të arredimit, nuk janë përfshirë me ndonjë zë më vete. Vlera e totale e apartamentit është 81,000 euro, nga të cilat, 11,000 euro vlera e arredimit, ndërsa pjesa tjetër vlera e apartamentit (nënkuptohet 70,000 euro).

**1.8** Subjekti ka depozituar dhe një deklaratë noteriale, datë 14.1.2020<sup>6</sup>, me deklarues shtetasin P.C., i vëllai i administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. A.C., i cili ka deklaruar se apartamentin që e ka në pronësi sot subjekti Flora Hajredinaj, ka qenë në pronësi të tij, duke deklaruar se: “... kam filluar të banoj në këtë apartament që nga muaji prill i vitit 2006. Duke menduar se ky apartament do ishte përfundimisht prona ime, kam bërë arredimin e tij në funksion të një jetese normale si dhe mbulesën e ballkonit...më pas për shkak të situatës ekonomike zgjodha të mbaj vetëm lokalin.... Apartamenti i mësipërm u është shitur blerësve duke u përfshirë në vlerën e apartamentit edhe vlera e arredimit. Ky fakt rezulton qartë dhe

<sup>2</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019. e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri.

<sup>3</sup> Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\*, datë 1.8.2006.

<sup>4</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 20.12.2012, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës shtetasen Flora Hajredinaj për apartamentin me sip. 133 m<sup>2</sup>.

<sup>5</sup> Udhëzimi nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB dhe të koeficientit K për vitin 2006”, i EKB-së.

<sup>6</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 14.1.2020, me deklarues P.C.

*nga çmimi i shitjes i cili ka qenë më i lartë se çmimi i shitjes së apartamenteve të tjera që nuk kanë qenë të arredhuara”.*

**1.9** Komisioni ka kërkuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., të depozitojë kontrata/marrëveshje dhe mandatpagesa që ka pasur me subjektin e rivlerësimit.

Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e sipërmarrjes, datë 1.8.2006<sup>7</sup>, mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 31.8.2006, si dhe kontratën e shitblerjes, datë 20.12.2012<sup>8</sup>, dokumentacion i administruar edhe më parë nga Komisioni.

**1.10** Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë kontrata/aktmarrëveshje të ngjashme që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka lidhur me persona të tjerë në të njëjtin pallat në të njëjtën periudhë.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision kontrata që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka lidhur me subjekte të tjera, ku ka rezultuar çmimi i shitjes<sup>9</sup> 550, 500 dhe 450 euro/m<sup>2</sup>.

Referuar kontratave, vihet re se këtyre subjekteve, apartamentet u janë shitur me çmim të përafërt me subjektin e rivlerësimit dhe, konkretisht, çmimi i shitjes te personat e tjerë ka variuar nga 550 euro/m<sup>2</sup>, 500 euro/m<sup>2</sup>, 450 euro/m<sup>2</sup> dhe për subjektin rreth 538 euro/m<sup>2</sup>.

**1.11** Komisioni ka administruar përgjigjen nga UKT-ja<sup>10</sup> ku ka rezultuar se nga sistemi i të dhënave rezultojnë dy abonentë me emrin K.H. Është konfirmuar kontrata për objektin e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë (apartamenti i subjektit në rrugën “\*\*\*\*”) dhe kontrata me emër të K.H. me nr. \*\*\*, për objektin të ndodhur në Rrugën e D., Tiranë, me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë, kontratë e vitit 2008.

**1.12** ASHK-ja nuk ka konfirmuar që në emër të shtetasit K.H. të rezultojë pasuri e paluajtshme me vendndodhje në Rrugën e D.

**1.13** Komisioni ka administruar shkresën nga OSHEE-së<sup>11</sup> ku me emrin K.H. rezultojë tre abonentë: (a) K.H. në instancën e Kukësit, qyteti Tropojë, lagjja “\*\*\*\*” (aktiviteti privat), e cila u përket lokaleve që ndodhen në qytetin e Tropojës në pronësi të K.H.; (b) K.H. në instancën e Tiranës, rruga “\*\*\*\*,” kabina “\*\*\*\*”; (c) K.H. në instancën e Tiranës, përballë vilës “\*\*\*\*”, kabina “\*\*\*\*”, Rruga e D.

Gjithashtu, OSHEE-së iu kërkua praktika e plotë e kontratës me shtetasin K.H. për objektin me adresë përballë vilës “\*\*\*\*”, kabina “\*\*\*\*”, Rruga e D., e cila me përgjigjen e saj<sup>12</sup> ka bërë me dije se nuk disponon kopje të kontratave para vitit 2007, pasi furnizimi me energji elektrike menaxhohej nga KESH sh.a.

---

<sup>7</sup> Kontratë e porosisë nr. \*\*\*, datë 1.8.2006, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositës shtetasen Flora Hajredinaj.

<sup>8</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 20.12.2012, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës shtetasen Flora Hajredinaj.

<sup>9</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 20.12.2012, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasi I. T. për apartamentin me sip. 92.46 m<sup>2</sup>, me çmimin 50,292 euro; kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 15.8.2015, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit A. L. për apartamentin me sip. 80.85 m<sup>2</sup> me çmimin 44,370 euro; deklaratë periodike e vitit 2006 e subjektit A. F., ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se A. F. e ka të njëjtin pallat dhe në mungesë të kontratës ka paraqitur deklaratën periodike të vitit 2006, ku ky subjekt deklaroi kontratë shitblerje për apartament me sip. 93.4 m<sup>2</sup> në tetor të vitit 2006 me çmimin 450 euro/m<sup>2</sup> ose në total në shumën 42,030 euro.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, UKT-së.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2019, e OSHEE-së.

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2019, e OSHEE-së.

**1.14** Komisioni ka administruar përgjigjen e DPGJC<sup>13</sup> e cila konfirmon se me emrin K.H. figuron vetëm një shtetas, me atësi T., i datëlindjes 16.6.1968, i lindur në Tropojë, me banim në Njësinë Bashkiake nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, Tiranë.

**1.15** Komisioni i është drejtuar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për të konfirmuar nëse subjekti i rivlerësimit ka lidhur ndonjë kontratë me këtë shoqëri meqenëse nga përgjigja e UKT-së dhe OSHEE-së rezulton emri i bashkëshortit të subjektit, z. K.H., i cili ka lidhur kontrata me këto ente. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje.

**1.16** Komisioni, me pyetësin nr. 3, ka kërkuar nga subjekti të provojë që kontratat me UKT-në dhe OSHEE-në me adresë Rruga e D., përballë vilës “\*\*\*\*”, nuk janë lidhur nga bashkëshorti i subjektit, z. K.H.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se konfuzioni ka ardhur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila kur ka dërguar listën e personave blerës të apartamenteve pranë UKT-së dhe OSHEE-së, ku për shtetasin K.A. është shkruar gabimisht mbiemri “*Hajredinaj...pas shumë kërkimesh mori dijeni se shtetasi K. A. ndodhet në shtetin Italian dhe se detyrimet e këtij apartamenti i paguan shtetasja D.A., e cila është një lidhje krushqie*”.

**1.16.1** Subjekti, në cilësinë e provës, ka depozituar: (i) shkresë me nr. \*\*\* prot, datë 25.2.2020, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku administratori i saj konfirmon kontratën me shtetasin K.A., i biri i I., i datëlindjes 23.12.1967; (ii) kontratë sipërmarrje e vitit 2004, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe porositës shtetasit K. dhe E.A.; (iii) kontratë shitje e vitit 2016 me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe blerës shtetasit K. dhe E.A. me adresë Rruga e D.; (iv) shkresë e UKT-së që konfirmon kontratën me shtetasin K.A.; (v) deklaratë noteriale, datë 26.2.2020, e shtetasës D.A., e cila deklaron faktin e pagesave që bën për apartamentin e shtetasit K.A.

**1.17** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin P.C. dhe, për këtë qëllim, ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPSHPKKO) dhe në përgjigjet e tyre është konfirmuar se ndaj shtetasit P.C. nuk rezulton të jenë dhënë vendime, si dhe nuk ka çështje aktualisht në gjykim në ngarkim të tij.

Komisioni nuk konstatoi situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, me shtetasin P.C. (shitësi i apartamentit).

**1.18** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë marrëdhënien e shtetasit P.C. me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**1.19** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës certifikatën e datës 9.9.2020 të trungut familjar të familjes C., ku shtetasi P.C. rezulton vëllai i shtetasit A.C., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**1.20 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të apartamentit me sip. 132.61 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”.**

Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe ka depozituar prova të plota që vërtetojnë se personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti K.H., nuk rezulton të ketë lidhur ndonjë kontratë me UKT-në dhe OSHEE-në, me adresë Rruga e D.

**Analizë burimit të krijimit të shumës 81,000 euro – çmimi i blerjes së apartamentit**

**1.21** Si burim krijimi për këtë shumë kanë shërbyer:

- kursimet bashkëshortore në periudhën janar 2004 – gusht 2006, në shumën 1,650,000 lekë;

---

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019. DPGJC-së.



- shuma 40,000 euro dhuratë bashkëshortit nga babai në vitin 2005;
- shuma 4,813,000 lekë kredi në “Raiffeisen Bank”, prej të cilave shuma 9,500 euro mbetet gjendje pas investimeve plotësuese në banesë.

### **1.22.1 Kursime bashkëshortore në periudhën janar 2004 – gusht 2006, në shumën 1,650,000 lekë.**

**1.22.1.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2004 kursime *cash* në shumën 500,000 lekë. Në vitin pasardhës, subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve vjetore *cash* në shumën 800,000 lekë, duke rezultuar me gjendje kursimesh në fund të vitit 2005 në shumën 1,300,000 lekë. Në deklarimin e vitit 2006, subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash* për vitin 2006, shumën prej 600,000 lekësh. Gjithashtu, në të njëjtën deklaratë subjekti ka deklaruar se këto kursime janë pakësuar me shumën 1,650,000 lekë, të përdorur për blerjen e apartamentit, duke rezultuar në fund të vitit 2006 me gjendje të kursimeve *cash* në shumën prej 250,000 lekësh.

**1.22.1.2** Kursimet e përdorura nga subjekti i rivlerësimit, për blerjen e apartamentit në shumën 1,650,000 lekë, kanë si burim krijimi të ardhurat nga pagat gjatë viteve 2004, 2005 dhe 2006, përkatësisht në shumat 500,000 lekë, 800,000 lekë dhe 600,000 lekë.

Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në vitet 2004 – 2006, nga ku rezultoi me balancë pozitive për këtë periudhë<sup>14</sup>.

### **1.22.2 Vlera 40,000 euro dhuratë bashkëshortit nga babai në vitin 2005**

**1.22.2.1** Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “*Shtuar shuma prej 40,000 euro në emër të bashkëshortit K.H., si pasojë e dhurimit nga babai i tij me rastin e ndarjes nga trangu familjar*”.

**1.22.2.2** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale, datë 31.10.2016<sup>15</sup>, me deklarues shtetasin T.H. (vjehtëri i subjektit), i cili deklaroi, ndër të tjera, se: “... se shuma prej 40,000 euro është kursyer bashkërisht... Shuma prej 40,000 euro përbëhet nga të ardhurat nga emigracioni i djalit S. dhe A., pensionet tona, qiratë e dyqaneve dhe rrogat e K. dhe bashkëshortes”.

### **1.22.3 Analizë krijimit të shumës 40,000 euro**

#### **a. Të ardhurat nga emigracioni të djalit S. dhe A.**

**a.1** Komisioni, me pyetësorin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti shpjegime në lidhje me kontributin e vëllezërve të bashkëshortit S. dhe A. nga emigracioni, si dhe dokumentacionin provues për realizimin e të ardhurave.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se nuk mund të përcaktojë saktësisht se sa ka qenë kontributi i vëllezërve të bashkëshortit, i cili ka qenë modest, ndërsa në lidhje me dokumentacionin provues të të ardhurave të realizuara prej tyre në emigracion, ka shpjeguar se ata nuk kanë mundur të gjejnë dokumentacion provues.

#### **b. Në lidhje me qiranë e përfituar nga dyqanet në Tropojë**

**b.1** Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “... të ardhura nga qiraja e lokaleve, (pa kontratë) në shumën 0.7 milion lekë dhe neto 0.68 milion lekë”. Po në faqen nr. 4 të formularit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Lokalet janë dhënë më qira që në vitin 1995 (të dyja)*”.

<sup>14</sup> Shihni analizën financiare në faqen nr. 37 të vendimit

<sup>15</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 31.10.2016.

**b.2** Komisioni, me pyetësonin nr. 6, ka kërkuar shpjegime nga subjekti në lidhje me deklarinimin e bashkëshortit për të ardhurat nga qiraja deklaruar në shumën *bruto* 70,000 lekë dhe në shumën 68,000 lekë *neto*.

Subjekti ka shpjeguar se shumata e deklaruara në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 janë shënuar për shkak se ishin në një përbërje familjare me prindërit dhe vëllezërit e bashkëshortit dhe, si të tilla, janë pasqyruar si të ardhura familjare vjetore.

Për njërin lokal me qiramarrës z. B.K., qiraja *bruto* ka qenë 30,000 lekë/muaj dhe *neto* 27,000 lekë/muaj, ndërsa për lokalin e dytë, subjekti nuk ka mundur të gjejë dokumentacion të plotë për të justifikuar vlerat e qirasë. Ndër të tjera, subjekti deklaroi se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 është deklaruar vlera e qirasë vjetore për të dy lokalet, referuar deklarimit “qiratë e lokaleve”.

**b.3** Subjekti ka shpjeguar se qiraja e përfutur nga vjehri ka qenë në vlerën 30,000 lekë/muaj (*bruto*) dhe e pandryshuar për periudhën 1995 – 2015. Kjo vlerë ka ndryshuar me marrëveshje të palëve në 20,000 lekë/muaj, pasi qiramarrësi ka pasur pretendime për shkak të rënies së xhiros. Kjo vlerë ka mbetur e pandryshuar dhe në vijim.

**b.4** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale, datë 23.1.2017<sup>16</sup>, me deklarues B.K., i cili ka deklaruar se me marrëveshje verbale ka marrë me qira një lokal shërbimi që nga janari i vitit 1995, ku dhe ushtron aktivitetin nga shtetasi T.H. (lokali në emër të djalit K.H.) në adresën lagjja “\*\*\*”, Bajram Curri. Nga momenti i marrjes me qira dhe deri më sot është rënë dakord që likuidimi i qirasë të bëhet *cash*, çdo fundmuaji. Fillimisht, në vitet 1995 – 2015, qiraja ka qenë në vlerën 30,000 lekë/muaj, ndërsa nga viti 2015 dhe në vazhdim vlera qirasë ulet në 20,000 lekë/muaj. Palët kanë rënë dakord që të gjitha detyrimet që rrjedhin nga faturat e energjisë elektrike, ujit dhe detyrime të tjera nga aktiviteti privat të paguhen nga qiramarrësi.

Shtetasi B.K. ka depozituar mandatar-këtimin nr. \*\*\*, datë 30.10.2014, lëshuar nga Bashkia Bajram Curri për pagesë taksash vendore.

**b.5** Komisioni ka administruar përgjigjen e DRT-së Kukës<sup>17</sup>, e cila konfirmon se shtetasi K.H. nuk rezulton të ketë paguar detyrime tatimore pranë kësaj drejtorie.

**b.6** Komisioni, me pyetësonin nr. 6, i ka kërkuar subjektit që të vërtetojë ushtrimin e aktivitetit tregtar të shtetasit B.K. nga viti 1995 dhe në vazhdim, si dhe regjistrimin në organet tatimore prej vitit 1995.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se, sipas shpjegimeve të vjehrit të saj, lokalet ia ka dhënë me mirëbesim shtetasit B.K., sipas një marrëveshje verbale qiraje dhe bashkëshorti nuk ka përfutur nga të ardhurat e qirasë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi janë përdorur për nevoja familjare. Gjithashtu, subjekti në vijim ka shpjeguar se menjëherë pas marrjes së këtij pyetësoni, bashkëshorti ka komunikuar me shtetasin B.K., për të marrë informacion në lidhje me historikun dhe regjistrimin e tij në organet tatimore që nga viti 1995. Shtetasi B.K. ka shpjeguar, mesa mbante mend, se në vitin 1995 kanë ushtruar aktivitet privat familjar.

Ndër të tjera, subjekti shpjegon se viti 1995 i përket kohës kur nuk ishte njohur me bashkëshortin dhe marrëveshjet dhe të ardhurat janë administruar nga vjehri. Më pas në kohën kur bashkëshorti i subjektit, z. K. ligjërisht ka fituar të drejta pronësie mbi këto pasuri marrëdhënia kontraktore është bërë në përputhje me parashikimet ligjore dhe ka qenë korrekte nga dy palët.

<sup>16</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.1.2017.

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2019, nga DRT-ja Kukës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2019, nga DPT-ja.

**b.7** Komisioni, me pyetësonin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat nga bashkëshorti, për qiranë e përfituar në periudhën 1995 – 2015.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se të ardhurat nga qiraja janë vjelë vetëm në vlerën takuese pas zbritjes së tatimit në burim, sepse qiramarrësit kanë qenë gjithnjë persona të cilët kanë ushtruar aktivitetet tregtar dhe, për rrjedhojë, jo vetëm kanë pasur të drejtën për të mbajtur vlerën e tatimit në burim, por njëkohësisht kanë pasur edhe detyrimin për ta derdhur këtë vlerë në llogari të administratës tatimore. Shtetasi B.K. konfirmoi mbajtjen e pjesës së tatimit në burim nga çmimi i përcaktuar për qiranë. Subjekti thekson se vlera e paguar është detyrimi i saktë për periudhën në fjalë, sipas legjislacionit në fuqi dhe se është llogaritur nga zyra e tatimeve<sup>18</sup>.

**b.8** Subjekti ka depozituar me cilësinë e provës: **(i)** deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 20.11.2019, me deklarues B.K., i cili ka deklaruar, ndër të tjera, se : “...kam ushtruar aktivitetin privat në lokalitetin pronë e shtetasit K.T.H. nga viti 1995 deri në mars 2017 dhe marrëdhënien e qirasë e kam pasur me shtetasin T.H. në mënyrë verbale dhe konkretisht qiraja ka qenë 30,000 lekë, vlerë e paguar dorazi nga ana ime. Kemi rënë dakord se detyrimin ndaj tatimeve do ta paguaja unë B.K. dhe, si rrjedhojë, kam mbajtur çdo muaj nga vlera e qirasë 3000 lekë për të likuiduar detyrimin e tatimit të qirasë tatimi, i cili nuk është bërë nga ana ime për shkakë neglizhence. Unë si deklarues, e njoh këtë detyrim që rrjedh nga ushtrimi i aktivitetit tim privat për periudhën e mësipërme dhe do e paguaj menjëherë”; **(ii)** mandatpagesën e lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, datë 20.11.2019, me përshkrimin “pagesë derdhje për segmentin e taksave me përfitues DPT në shumën 825,275 lekë nga B.K.”, për periudhën 1995 – maj 2017.

**c. Llogaritja e pensioneve të shtetasve T. dhe B.H.** Subjekti, në përgjigje të pyetësonit nr. 2, ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit.

**c.1** Sipas vërtetimit të ISSh-së<sup>19</sup>, shtetasi T.H. ka përfituar për periudhën 1.2.1993 – 30.4.2005, të ardhura nga pensioni në shumën 696,275 lekë. Komisioni referuar këtyre të dhënave ka llogaritur mundësinë e shtetasit T.H. për kursime, duke rezultuar me pamundësi financiare për të kursyer, pasi të ardhurat totale të përfituara nga pensionet janë në shumën 696,275 lekë dhe shpenzimet jetike janë në shumën 770,630 lekë<sup>20</sup>.

**c.2** Komisioni ka llogaritur në të njëjtën mënyrë mundësinë e shtetasve B.H. për të kursyer me të ardhurat e pensionit dhe sipas vërtetimit të ISSh-së<sup>21</sup>, shtetasja B.H. ka përfituar për periudhën 1.2.1993 – 30.4.2005, të ardhura nga pensioni në shumën 683,908 lekë, duke rezultuar me pamundësi financiare për të kursyer, pasi shpenzimet jetike për këtë periudhë janë në shumën 761,973 lekë.

#### **d. Pagat e subjektit dhe bashkëshortit K.H.**

Komisioni, me pyetësonin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të specifikojë pjesën e investuar nga pagat në shumën 40,000 euro.

**d.1** Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se pas specifikimit të vlerës së pagës së bashkëshortit, pjesa e investuar në shumën 40,000 euro, ka qenë rreth 300.000 lekë, ndërsa me të ardhurat nga paga e saj, pjesa e investuar ka qenë rreth 2.080.000 lekë.

<sup>18</sup> Shpjeguar nga subjekti në pyetësonin nr. 4.

<sup>19</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2019, i ISSh-së.

<sup>20</sup> Shpenzimet jetike për periudhën deri në vitin 1996 janë llogaritur në masën 70% të të ardhurës së përfituar nga pensioni; për periudhën 1997-1999 janë llogaritur 5,000 lekë/muaj për person, ndërsa nga viti 2000 e në vazhdim sipas shkresës së ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot, datë 4.3.2019.

<sup>21</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2019, i ISSh-së.

**d.2** Komisioni ka llogaritur mundësinë e bashkëshortit të subjektit për të kursyer nga të ardhurat nga paga nga ku rezulton se, pasi janë zbritur shpenzimet jetike ka pasur mundësi të kursejë shumën 512,092 lekë<sup>22</sup>, ndërsa në lidhje me mundësinë e subjektit për kursime nga pagat, duke i zbritur të ardhurave të përfituara shpenzimet jetike, rezulton se ka pasur mundësi të kursejë në shumën 1,885,946 lekë dhe jo shumën 2,080,000 lekë, sikundër është deklaruar nga subjekti se ka shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 40,000 euro. Për periudhën 2001– 2003 janë zbritur shpenzimet jetike dhe për djalin e subjektit.

**1.22.3.1** Komisioni, pasi analizoi secilin burim të ardhurash të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me mundësinë dhe ligjshmërinë e krijimit të tij, analizoi edhe mundësinë financiare për krijimin e shumës së dhuruar 40,000 euro.

Nga analiza e mëposhtme duket se babai i bashkëshortit nuk justifikon me të ardhura të mjaftueshme shumën prej 40,000 euro, dhuruar djalit të tij, bashkëshortit të subjektit.

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>2,185,946</b>
1	Kursime të vëllezërve të bashkëshortit nga emigracioni	0
2	Kursime nga të ardhurat nga pensioni T. H. 1.2.1993 – 30.4.2005	0
3	Të ardhura nga qiraja e dyqanit në Tropojë 1995 – 30.4.2005	0
4	Kursime nga të ardhurat nga pensioni B. H. 1.6.1994 – 30.4.2005	0
5	Kursime nga të ardhurat nga paga e bashkëshorti 1986-2001	300,000
6	Kursime nga të ardhurat nga paga e subjektit 1.9.1996 – 31.12.2003	1,885,946
<b>B</b>	<b>Dhurime</b>	<b>4,901,600</b>
1	Shuma e dhuruar nga prindërit e bashkëshortit 40,000 euro x 122,54	4,901,600
	<b>Mundësia financiare për dhurimin e shumës 40,000 euro (A-B)</b>	<b>-2,715,654</b>

#### **1.22.4 Kredi lehtësuese në vlerën 5,000,000 lekë marrë në “Raiffeisen Bank”**

**1.22.4.1** “Raiffeisen Bank”<sup>23</sup> ka konfirmuar kredinë e dhënë subjektit Flora Hajredinaj marrë në datën 30.8.2006, në shumën 5,000,000 lekë. Ky veprim është pasqyruar në kontratën e kredisë bankare dhe hipotekës, datë 28.8.2006,<sup>24</sup> lidhur me kredidhënës “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrës shtetasit Flora dhe K.H. dhe hipotekues shtetasit Y. dhe F.T.<sup>25</sup>, për marrjen e kredisë prej 5,000,000 lekësh për një afat prej 300 muaj me normë interesi prej 12%. Nga kjo normë interesi, kredimarrësi do të paguajë 3% interes mbi shumën, ndërsa pjesa tjetër e interesit do paguhet nga Ministria e Financës.

<sup>22</sup> Shpenzimet jetike për periudhën deri në vitin 1996 janë llogaritur në masën 70% të të ardhurës së përfituar nga paga; për periudhën 1997-1999 janë llogaritur 5,000 lekë/muaj për person, ndërsa nga viti 2000 e në vazhdim sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2019, së ILDKPKI-së.

<sup>23</sup> “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot, datë 6.9.2019.

<sup>24</sup> Kontrata e kredisë bankare dhe hipotekë me nr. \*\*\*, datë 28.8.2006.

<sup>25</sup> Sigurimi i kredisë nga kredimarrësi bëhet me anë të garancisë nga hipotekimi i pasurisë së paluajtshme apartament nr. \*\*\* pasurie me sipërfaqe 63 m<sup>2</sup> dhe 32 m<sup>2</sup> verandë, rruga “\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të shtetasve Y. dhe F.T.

Me kontratën e hipotekës, datë 19.1.2010<sup>26</sup>, hipotekuesja F.H., garanton kredinë e dhënë subjektit Flora Hajredinaj në shumën 5,000,000 lekë, me pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 91m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të saj.

**1.22.4.2** Kontrata e kredisë bankare nënshkruhet midis palëve në mbështetje dhe në zbatim të marrëveshjes nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2005, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve të lartë të shtetit”, të lidhur ndërmjet RBAL dhe Ministrisë së Financave. Sipas shkresës së datës 11.7.2006<sup>27</sup>, “Për trajtim me kredi për strehim”, ku i akordohet kredi për strehim personave sipas listës nr. \*\*\*, që i bashkëlidhet kësaj shkrese, subjekti i rivlerësimit Flora Hajredinaj rezulton me numër rendor \*\*\* dhe ka përfituar kredinë në shumën 5,000,000 lekë.

**1.22.4.3** VKM-ja nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, ka përcaktuar si kriter në pikën 2 të saj që ...nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, të mos kenë banesë në momentin që përfitojnë kredinë e butë nga shteti dhe më konkretisht: *“Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti”*.

**1.22.4.4** Subjekti i rivlerësimit në momentin që ka përfituar kredinë me kushte lehtësuese të miratuar nga shteti nuk ka pasur banesë tjetër në pronësi, kështu dhe përfitimi i kredisë është bërë në përputhje të zbatimit të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

**1.22.4.5** Komisioni ka hetuar dhe në lidhje me shtetasit Y. dhe F.T.<sup>28</sup> për ndonjë situatë konflikti interesi me shtetasit Flora dhe K.H. dhe për këtë arsye ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë<sup>29</sup>.

Të dyja gjykatat e sipërcituara, kanë konfirmuar se ndaj dy shtetasve të lartpërmendur nuk ka çështje në gjykim dhe nuk janë dhënë vendime gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit.

## **1.23 Aftësia paguese e subjektit për blerjen e apartamentin me çmimin 81,000 euro sipas burimeve të deklaruara**

**1.23.1** Komisioni analizoi aftësinë paguese të subjektit në momentin e kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentin me çmimin 81,000 euro sipas burimeve të deklaruara prej saj. Referuar kontratës së sipërmarrjes në datën 1.8.2006, subjekti ka paguar shumën 51,000 euro para nënshkrimit të kontratës, por pa përcaktuar datën e likuidimit. Me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 31.8.2006, subjekti ka paguar shumën 30,000 euro me përshkrimin *“likuidimi u krye i plotë për apartamentin”*.

**1.23.2** Sipas analizës financiare, subjekti ka pasur në dispozicion në momentin e kryerjes së pagesës për këstin e parë deri në datën 1.8.2006, shumën 13,542 euro me burim kursimet *cash* të akumuluar në shumën prej 1,650,000 lekësh, të konvertuara sipas kursit të datës 1.8.2006 në shumën 13,542 euro.

---

<sup>26</sup> Kontrata e hipotekës nr. \*\*\*, datë 19.01.2010, me hipotekuese Flora Hajredinaj.

<sup>27</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.7.2006, Kryeministrit.

<sup>28</sup> Subjekti ka shpjeguar dhe lidhjen me shtetasit Y. dhe F.T. se me to ka lidhje krushqie (F. është kunata motrës se bashkëshortit të saj).

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda; shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2019, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

**1.23.3** Duket se shuma prej 13,542 euro nuk është e mjaftueshme për mbulimin e pagesës së kryer deri në datën 1.8.2006, në shumën 51,000 euro, duke rezultuar me mungesë burimesh në shumën 37,458 euro.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi edhe kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në datë 31.8.2006, në shumën 4,813,000 lekë. Duket se kjo kredi ka shërbyer si burim krijimi për pagesën e kështit të dytë në datën 31.8.2006, në shumën 30,000 euro.

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në euro</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë</b>	<b>13,542</b>
1	Shuma e dhuruar nga prindërit e b/sh me burime të ligjshme, disponuar <i>cash</i>	0
2	Kursime <i>cash</i> të akumuluar 1,650,000 lekë me burim pagat konv. në datën 1.8.2006, me kursin 121.84 (=1,650,000/121.84)	13,542
<b>B</b>	<b>Pasuri – Blerje apartamenti me çmimin 81,000 euro</b>	<b>51,000</b>
1	Pagesa e kështit të parë të shtëpisë më 1.8.2006, në shumën 51,000 euro	51,000
	<b>Mundësia financiare për pagesën e kështit të I të apartamentit deri në datën 1.8.2006 (A-B)</b>	<b>-37,458</b>
<b>C</b>	<b>Të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë</b>	<b>30,000</b>
1	Pjesa e mbetur pas pagesës së kështit të I	0
2	Kredi bankare 4,813,000 lekë nga e cila është kursyer 9,500 euro (=4,813,000/121.849 - 9,500 euro), konvertuar në datën 31.8.2006	30,000
<b>D</b>	<b>Pasuri – Blerje apartamenti me çmimin 81,000 euro</b>	<b>30,000</b>
1	Pagesa e pjesës së mbetur të çmimit të shtëpisë në shumën 30,000 euro, në datën 31.8.2006	30,000
	<b>Mundësia financiare për pagesën e kështit të II të apa në datë 31.08.2006 (C-D)</b>	<b>0</b>

**1.24** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se:

- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllezërve të bashkëshortit, S. dhe A.H., nga emigracioni, pavarësisht se subjekti ka deklaruar se kontributi i tyre ka qenë i vogël;
- në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar vetëm të ardhura nga qiratë, por duket se nuk kanë deklaruar gjendje *cash*, likuiditete, gjendje në bankë apo kursime në vitin 2003;
- personi tjetër i lidhur, qiramarrësi B.K., ka paguar me vonesë, në vitin 2019, tatimin në burim për të ardhurat nga qiraja, por është e paqartë mënyra e përlogaritjes së penaliteve për këto detyrime sipas legjislacionit tatimor të kohës;
- babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme të mjaftueshme shumën prej 40,000 euro, dhuruar djalit të tij, z. K.H., (bashkëshorti i subjektit);
- subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në shumën 37,458 euro.

**1.25** Në lidhje me konstatimet e mësipërme, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, subjektit të rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar si vijon:

**1.26.1** Në lidhje me të ardhurat nga vëllezërit e bashkëshortit siç është shpjeguar dhe më parë në pyetësorë, kanë qenë të ardhura simbolike dhënë prindërve dhe janë administruar prej tyre.

**1.26.2** Subjekti dhe bashkëshorti i saj, në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, nuk kanë pasur detyrim të deklarojnë kursimet e nënës dhe babait të bashkëshortit edhe pse jetonin në një ekonomi të përbashkët, por kanë deklaruar vetëm kursimet e tyre. Ndërsa kursimet e tjera (përfshirë ato nga qiraja) administroheshin nga babai i bashkëshortit.

**1.26.3** Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës 40,000 euro të deklaruara që në vitin 2005 në DIPP-në përkatëse, rreth 10 vjet përpara miratimit të ligjeve të reformës në drejtësi, subjekti kërkon nga Komisioni të marrë në konsideratë kushtet dhe rrethanat konkrete të periudhës në të cilën janë fituar ato të ardhura: *së pari*: deri në blerjen e apartamentit, subjekti deklaroi se ka jetuar në një ekonomi të përbashkët me familjen e bashkëshortit, prandaj llogaritja e të ardhura dhe shpenzimeve dhe mundësisë për kursime të bëhet për të gjithë familjen bashkë.; *së dyti*: në lidhje me të ardhurat nga dyqanet e dhëna me qira, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si më lart; *së treti*: në lidhje me të ardhurat e qirasë (lokalit) në Tropojë, subjekti shpjegon se qiramarrësi B.K., jo vetëm ka pohuar me deklaratimet e tij marrëdhënien e qirasë, por edhe ka paguar më pas detyrimet tatimore përfshirë dhe tatimin në burim. Fakti i pagimit të detyrimit tatimor, të të ardhurave nga qiraja, ndonëse nuk është kryer në kohë nga qiramarrësi, është korrigjuar menjëherë sapo subjekti ka ardhur në dijeni të kësaj problematike dhe kjo duhet të vlerësohet si një tjetër argument në favor të të ardhurave të ligjshme nga qiraja çka ndikon pozitivisht në provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të viteve 1995 – 2015.

Përveç dokumentacionit të dërguar më parë në lidhje me qiramarrjen, subjekti ka depozituar gjithashtu: (i) *vërtetim i degës së sigurimeve shoqërore Tropojë*<sup>30</sup> që vërteton se B.K. nuk figuron i siguruar pranë kësaj dege në ndërmarrje shtetërore për periudhën 1994 – 2010; (ii) *përgjigje e DRT-së Kukës*<sup>31</sup> ku nga verifikimi në sistem për periudhën janar 1995 – mars 2012 B.K. nuk figuron i regjistruar pranë DRT-së Kukës, por ky shtetasi është regjistruar si person fizik në datën 15.3.2012 dhe më pas i çregjistruar në vitin 2015; (iii) *deklaratë noteriale të shtetasve*<sup>32</sup> të ndryshëm të cilët konfirmojnë ushtrimin e aktivitetit privat të B.K. në lokalet e T.H. që nga viti 1995.

**1.26.4** Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të mbajë të njëjtin qëndrim si me disa vendime të mëparshme dhënë nga Komisioni, të cilat subjekti i referon në shpjegimet e tij. Komisioni duhet të mbajë parasysh faktin se arrihet të provohet ekzistenca e ushtrimit të aktivitetit privat të bashkëshortit në vitet 1992 – 1995, vërtetuar dhe me vërtetimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë që vërteton hapjen e biznesit të shtetasit K.H. me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.4.1992.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

**1.27** Komisioni mori në analizë burimet e krijimit të shumës 81,000 euro të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

**1.27.1** Komisioni ka analizuar burimin e parë, të ardhurat nga kursimet e pagave të subjektit dhe bashkëshortit për periudhën janar 2004 – gusht 2006, në shumën 1,650,000 lekë dhe ka rezultuar se kanë pasur mundësi për të krijuar këtë shumë.

<sup>30</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, i DRSSH-së Tropojë.

<sup>31</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, e DRT-së Kukës.

<sup>32</sup> Deklaratat noteriale nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, e shtetasit H.M.; nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, e shtetasit R.M.; nr. \*\*\*, datë 10.3.2020 i shtetasit H.A.; nr. \*\*\*, datë 9.3.2020; nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, e shtetasit Sh.H. dhe nr. \*\*\*, datë 17.3.2020, e shtetasit B.I.

**1.27.2** Gjithashtu, Komisioni ka analizuar burimin e dytë, që është dhurimi i shumës 40,000 euro, si dhuratë nga babai i bashkëshortit.

Fillimisht, Komisioni pranon pretendimin e subjektit se ajo dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti, në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003<sup>33</sup>, nuk ka pasur detyrim të deklarojnë në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, kursimet e nënës dhe babait të bashkëshortit edhe pse jetonin në një ekonomi të përbashkët dhe, për më tepër, prindërit nuk mund të konsiderohen as si në ngarkim të subjektit dhe bashkëshortit të saj, marrë shkas nga fakti që vjehri i subjektit ka qenë kryefamiljari i familjes së madhe. Për këtë arsye, nuk është deklaruar si kursim shuma prej 40,000 euro e dhuruar nga babai i bashkëshortit. Pavarësisht kësaj, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 marrëdhënien e qirasë prej vitit 1995 dhe në vazhdim, si dhe vlerën e qirasë vjetore të përfituar.

Fillimisht, është analizuar burimi i shumës 40,000 euro, ku janë përfshirë një pjesë e të ardhurave nga vëllezërit e bashkëshortit të realizuara në emigracion, të cilat nuk u provuan me dokumentacion ligjor, por kjo shumë ka qenë e papërfillshme në shumën 40,000 euro.

Nga Komisioni është analizuar mundësia për kursime, që sipas subjektit duhej bërë për të gjithë familjen, pasi deri në blerjen e apartamentit kishin jetuar në një ekonomi të përbashkët. Por ky pretendim nuk qëndron, pasi më herët nga subjekti është deklaruar se deri në vitin 2003 kanë jetuar me familjen e bashkëshortit dhe duke filluar nga viti 2004, subjekti dhe bashkëshorti kanë jetuar në të njëjtën banesë me prindërit e bashkëshortit, por me ekonomi të ndarë.

Janë marrë në konsideratë pagat e subjektit dhe bashkëshortit deri më 31.12.2003 dhe pas zbritjes së shpenzimeve jetike, si kursim nga pagat janë përfshirë edhe shumat 300,000 lekë dhe 1,885,946 lekë, në totalin e 40,000 euro.

Në lidhje me pensionet e vjehrrit dhe vjehrrës së subjektit (T. dhe B.H.) nga analiza financiare e kryer deri më 30.4.2005, rezulton se nuk kanë pasur mundësi të kursejnë.

Në lidhje me burimin tjetër të shumës 40,000 euro, që janë të ardhurat nga qiraja, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet bindëse dhe Komisioni ka konkluduar se janë të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe duhen marrë në konsideratë duke arsyetuar, si vijon:

i) Dy njësitë (dyqanet) të dhëna me qira janë pasuri të paluajjtshme që përdoren dhe janë përdorur vetëm për aktivitet tregtar. Ky fakt provohet nga kontratat e blerjes së lokaleve në vitin 1993 nga shtetasi K.H. (ku në kontratë përcaktohet destinacioni i tyre si lokale). Me anë të një vërtetimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë vërteton se shtetasi K.H. ka qenë regjistruar dhe njohur si person juridik privat me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.4.1992, të saj. Po kështu, edhe vërtetimi i Bankës së Bujqësisë dhe e Zhvillimit, datë 18.4.1992, vërteton se shtetasi K.H. është pronar i ndërmarrjes tregtare-blegtorale “\*\*\*”.

ii) Subjekti i rivlerësimit që në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 ka deklaruar dhënien me qira dhe të ardhura të përfituara nga marrëdhënia e qirasë në vlerë *neto* 68.000 lekë.

iii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë përfituesi i drejtpërdrejtë i vlerave të qirasë, pasi të ardhurat nga qiramarrja janë përfituar dhe administruar nga babai i personit të lidhur, shtetasi T.H., nën cilësinë e kryefamiljarit. Subjekti nuk ka qenë pjesëtare e familjes së madhe H. në

---

<sup>33</sup> Neni 21, deklarimi, përcakton: “*Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit...*”.



vitin 1995, kur është lidhur marrëdhënia e qirasë. Ky fakt përveç se provohet me deklaratën noteriale të vjehrrit T.H., duke qenë se subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin dhe djalin jetonin në një familje të përbashkët me vjehrrin T., vjehrrën dhe dy vëllezërit e bashkëshortit, në këto familje të mëdha njihet zakoni dhe tradita që i pari i familjes drejtonte administronte dhe investonte të gjitha pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e familjes sipas nevojës së anëtarëve të saj. Kjo lloj marrëdhënieje njihet dhe nga e drejta zakonore shqiptare si një nga burimet e së drejtës, si e drejtë popullore e pashkruar, e transmetuar brez pas brezi nga tradita gojore që ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike gjatë shekujve në vendin tonë<sup>34</sup>.

iv) Shtetasi T.H. si qiradhënës dhe shtetasi B.K. si qiramarrës, kanë pasur të lidhur një marrëdhënie qiraje të paformalizuar me një kontratë noteriale. Marrëdhënia e qirasë ndërmjet tyre ka qenë verbale, pasi lidhej për një periudhë njëvjeçare dhe përtërihej vit pas viti, marrëdhënie kjo e cila njihet si një format i lidhjes së kontratës së qirasë parashikuar nga dispozitat e Kodit Civil<sup>35</sup>.

v) Marrëdhënia e qirasë ndërmjet qiramarrësit B.K. dhe qiradhënësit T.H. provohet me prova dhe burime të tërthorta, siç janë edhe deklaratat noteriale<sup>36</sup> të personave të ndryshëm si ish-punonjës i B.K., bashkëpunëtorë të tij në tregti dhe tregtarë fqinj, që konfirmojnë faktin se lokalet në pronësi të shtetasit T.H. që nga viti 1995 i ka marrë me qira shtetasi B.K., i cili ushtron aktivitet tregtar nga viti 1995 dhe deri më sot. Këtë e përforcon dhe fakti që edhe sot shtetasi B.K. vijon të paguajë taksa pranë Bashkisë Bajram Curri<sup>37</sup>, për aktivitet tregtar që vazhdon të ushtrojë në po të njëjtin ambient tregtar.

vi) Në një marrëdhënie të tillë qiramarrje, ku qiramarrësi është person fizik tregtar, detyrimin për të paguar tatimin mbi të ardhurat e ka qiramarrësi. Ky rregull është përcaktuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat” i ndryshuar<sup>38</sup>, si dhe bazuar në opinionin të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve Tiranë<sup>39</sup>, e cila konfirmon detyrimin e personit fizik tregtar për të mbajtur tatimin në burim në marrëdhënien e qirasë.

<sup>34</sup> Për shkak të traditës familjare, kryefamiljari T.H. në deklaratën noteriale të datës 31.10.2016, përpara deklaratës *Vetting*, ka deklaruar dhurimin e shumës 40,000 euro djalit K.H., meqenëse krijoi familjen e tij dhe do largohej nga familja e madhe në një banesë tjetër.

<sup>35</sup> Neni 803 Qiraja ... Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë

<sup>36</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, me deklarues H.M., deklaronte se ka ushtruar aktivitetin tregtar ngjitur me lokalit dhe marrë me qira nga B.K. që nga viti 1995 e në vijim; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, me deklarues R.M., i cili deklaronte se në vitin 1995 ka qenë i punësuar në lokalit e B.K.; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, me deklarues H.A., i cili deklaronte se deklaronte se gjatë viteve 1995 – 2000, ka furnizuar me artikuj të ndryshëm lokalit “Bar-Kafe”, që administrohet nga B.K.; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, me deklarues Sh.H., i cili deklaronte se që nga viti 1995 ka biznes që e ushtron pranë lokaleve pronë e T.H. por i marrë me qira që nga viti 1995 nga B.K. dhe deri më sot.

<sup>37</sup> Njoftim detyrimi i datës 26.1.2015, i Bashkisë Bajram Curri për tatim-paguesin B.K.

<sup>38</sup> Neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, 1. *Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislati në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme (dh) pagesat për qiratë”.*

<sup>39</sup> Sipas një opinion nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tatimeve, si dhe Ministria e Financave, lidhur me detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislatit ndër vite. Në përgjigjen e datës 14.5.2018, shpjegohet se detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie, apo kryen pagesa të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislatit tatimor. Duke qenë se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ka ndryshuar, edhe procedura, llogaritja, mënyra e deklarimit dhe e pagesës së tatimit ka ndryshuar. 26 1. Për periudhën janar 1999 – 2001, të ardhurat e siguruar nga qiradhënia duhet të deklaroheshin nga vetë përfituesi i të ardhurave. Pagesa bëhej sipas shumave të përcaktuara në kontratë. 2. Për periudhën 2002 e në vijim, kemi dy momente: 2.1 Kur qiramarrësi është individ, është vetë individi përfituesi i të ardhurave nga qiraja që duhet të deklarohet dhe të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale, sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, nga viti 2004 deri në vitin 2012, individi përfituesi i të ardhurave nga qiraja, apo nga çdo burim tjetër, për të cilat nuk ishte paguar tatimi në burim, duhet t’i deklaronte këto të ardhura në organin tatimor jo më vonë se 30 janari i vitit pasardhës. 2.2 Kur qiramarrësi është person juridik, ortakëri, person fizik, rezident tatimor në Shqipëri, organi i qeverisjes qendrore apo vendore, OJF-të, ENT-të dhe që bën pagesë të qirasë, mban në burim tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor, si një tatim përfundimtar dhe, në këtë mënyrë, individi qiradhënës nuk ka detyrim që të dorëzojë deklaratën tatimore. Sjellim

vii) Gjithashtu, nga qiramarrësi B.K. është deklaruar se ka ushtruar në vitet 1995 – 2015, aktivitet tregtar si biznes në këto lokale të marra me qira nga familja Hajredinaj (me 30,000 lekë/muaj) dhe si detyrim për të paguar tatimin mbi të ardhurat në cilësinë e biznesit, pagesa e tatimit ka qenë detyrim i tij. Të dyja palët kanë konfirmuar se pagesa e qirasë është bërë gjithmonë në vlerën *neto* 27,000 lekë/muaj, duke u mbajtur nga qiramarrësi pjesa e tatimit në burim dhe si e tillë është deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003. Ky fakt është konfirmuar nga shtetasi B.K. me deklaratën noteriale të vitit 2017<sup>40</sup>

viii) Ushtrimi i aktivitetit tregtar nga shtetasi B.K. provohet edhe nga vërtetimi i sigurimeve shoqërore<sup>41</sup> se ky shtetas nuk rezulton të ketë qenë i punësuar në ndërmarrje shtetërore për periudhën 1994 – 2010.

ix) Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në marrëdhënie të drekte qiradhënie-qiramarrje me shtetasin B.K., nuk ka qenë pronare e dy lokaleve, si dhe nuk ka qenë pjesëtare e familjes Hajredinaj në vitin 1995 kur është lidhur marrëdhënia e qirasë, pagesa e qirasë është bërë gjithmonë në vlerën *neto*, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore për mospagimin e detyrimeve tatimore që me ligj i takojnë për t'u paguar nga qiramarrësi dhe, për më tepër, nuk ka qenë në dijeni të mospagimit të këtij detyrimi.

x) Rezulton se pas vënies në dijeni nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ për të ardhurat e përfituara nga qiraja, subjekti ka informuar qiramarrësin B.K. në lidhje me pagimin ose jo të tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja si detyrim i tij.

Shtetasi B.K. në deklarimet e tij, ka pranuar që përgjegjësia për pagimin e të ardhurave të përfituara nga vjehtëri i subjektit, ndër vite, ka qenë përgjegjësi e tij. Shtetasi B.K. ka paguar tatimin mbi të ardhurat në shumën 825,275 lekë, në datën 20.11.2019, për të ardhurat e përfituara nga qiraja për periudhën 1995 – 2016.

Komisioni ka llogaritur të ardhurën *neto* të përfutur nga qiraja për çdo vit sipas legjislacionit tatimor në fuqi në lidhje me normën e tatimit, konkretisht, sipas ligjit nr. 7897, datë 2.2.1995, “Për tatimin mbi të ardhurat”; ligjit nr. 8091, datë 21.3.1996; si dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ndryshuar me ligjin nr. 177/2013, datë 28.12.2013. E ardhura *neto* nga qiraja është e ardhura *bruto* e mbetur pasi zbritet tatimi mbi qiranë.

Totali i të ardhurave të përlllogaritura nga Komisioni në shumë 6,805,000 lekë, i referohet shumës së të ardhurave për të cilën është paguar tatimi mbi qiranë në shumën 825,000 lekë. Komisioni ka marrë në analizë dhe të ardhurat nga qiraja deri në datën 30.4.2005, në vlerën prej 3,325,500 lekësh, të cilat së bashku me kursimet nga pagat plotësojnë shumën e dhuruar prej 40,000 euro.

Komisioni vlerëson se në tërësi të fakteve dhe rrethanave të lartpërmendura, të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit për këtë rast, duke u konsideruar si një nga mjetet e kërkimit të provës në kuptim të gërmës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ato marrin vlerë provuese të rëndësishme, për sa kohë gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat e tjera që japin aktet e paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit dhe duke mos e paslidhur me detyrimime ligjore të subjektit nën vlerësimin tërësor të rrethanave të arsyetuara më sipër, konsiderohen konsiderohen prova në kuptim të nenit të sipërcituar.

---

në vëmendje se në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, (i ndryshuar), në pikën 5.5 “Evidentimi i tatimit të mbajtur në burim”, përcaktohet se: Tatimi i mbajtur në burim evidentohet nëpërmjet regjistrimeve në librat përkatës të evidentimit, të cilat përmbajnë të dhëna të plota identifikuese për personat përfitues, ... personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat sipas përcaktimeve të nenit 33, të ligjit, duhet t’ia vërë ato në dispozicion administratës tatimore dhe personave përfitues të të ardhurave, për të cilat është bërë pagesa, kur një gjë e tillë kërkohet.

<sup>40</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.1.2017.

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë.

**Komisioni arriti në përfundimin se të ardhurat e përfituara nga qiraja janë të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe Komisioni vlerësoi t’i marrë në konsideratë në analizën financiare.**

**Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të blerë në shumën 81,000 euro, apartamentin me sip. 119.56 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.**

**2. Pasuria me sip. 120 m<sup>2</sup> (pjesë e një kati), në ndërtimin e banesës 3+1, në proces legalizimi, ndodhur në Njësinë Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë, e pabanueshme. Vetëdeklarimi pranë ALUIZNI-t është bërë në emër të bashkëshortit të subjektit, z. K.H., në vlerën 21,500 euro. Pjesë takuese në bashkëpronësi.**

**Burimi i krijimit:** (a) këmbimi i detyrimit të huas nga babai i bashkëshortit dhënë atij në vitin 2008 të përbëra nga pjesa e mbetur e kredisë bankare në vlerë 9,500 euro; (b) një pjesë e kursimeve bashkëshortore dhe dhuratat familjare në periudhën 2006 – 2008

### **Hetim administrativ i kryer nga Komisioni**

**2.1** Në DIPP-në vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Pakësuar shuma 21,500 euro e dhënë hua vjehrrit tim T.H. me deklarim gojor pa akt noterial për banesë, pa afat, me pëlqimin e të dy bashkëshortëve me burim – kursimet e vëna gjatë viteve”*. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *“Pakësuar gjatë 2013 shuma prej 21,500 euro deklaruar vite më parë si hua dhënë vjehrrit dhe kunetërve të mi, pasi deklaruan se kjo shumë është investuar në ndërtimin e një shtëpie banimi të filluar në vitet 1998 – 1999 dhe në proces legalizimi u përfshi dhe bashkëshorti im K. Ky ndërtim është paraqitur për legalizim në datën 21.6.2013. Në këtë objekt mbi bazë të kontributit tonë 21,500 euro do të jemi pjesëtarë me 1/3 e objektit saktësisht 1 kat me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>. Papafingo dhe bodrumi do të jenë sipërfaqe të përbashkëta, pjesa tjetër është e kunetërve të mi. Me investimin dhe ndjekjen e punimeve është marrë kunati im. Aktualisht banesa nuk ka përfunduar ende”*.

**2.2** ASHK-ja Tiranë<sup>42</sup> konfirmon se shtetasi K.H. rezulton aplikues dhe deklarues në procesin e legalizimeve së bashku me shtetasit A.H. dhe S.H., për legalizimin e objektit 3 kat + 1 kat nëntokë + papafingo me sipërfaqe baze ndërtimi 120 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 600 m<sup>2</sup> me sipërfaqe trualli 240 m<sup>2</sup>, sipas formularit nr. \*\*\*, datë 21.06.2013 (vetëdeklarim formular 2013, nr. \*\*\* prot., Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, Tiranë), gjithashtu, thekson se kjo praktikë legalizimi është e patrajtuar.

**2.3** Komisioni ka analizuar dhe vlerën e koston së ndërtimit, referuar Udhëzimit të EKB-së<sup>43</sup> kosto mesatare për sipërfaqe ndërtimi për vitin 2008 për qytetin e Tiranës, është 27,681 lekë/m<sup>2</sup>. Duke llogaritur sip. 120 m<sup>2</sup> x 27,681 lekë = 3,321,720 lekë.

Konstatohet se shuma prej 21,500 euro e përdorur si investim për ndërtimin e katit është e përafërt me çmimin mesatar për kosto ndërtimi për vitin 2008 referuar EKB-së.

**2.4 Komisioni ka analizuar mundësinë financiare për krijimin e shumës 21,500 euro dhënë hua babait të bashkëshortit.**

**2.4.1** Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar hua dhënë babait të bashkëshortit në shumën 21,500 euro me burim krijimi kursimet *cash*.

---

<sup>42</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2019, e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2019, ASHK-ja Drejtoria e Përgjithshme; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019, e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug.

<sup>43</sup> Udhëzimi nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008”.

**2.4.2** Komisioni konstaton se kursimet *cash* të përdorura nga subjekti i rivlerësimit për dhënien hua të shumës 21,500 euro, referuar deklarimeve periodike, kanë si burim krijimi të ardhurat nga pagat, shumën prej 9,500 euro nga pjesa e papërdorur e kredisë të deklaruar në vitin 2006 dhe shumën e dhuruara nga të afërmit.

**2.4.3** Në lidhje me shumën e dhuruar nga vëllai i subjektit të rivlerësimit në vlerën 3,000 GBP dhe shumën e dhuruar nga vëllai i bashkëshortit në vlerën 5,000 USD, subjekti ka analizuar burimin e ligjshëm të tyre në pikat 7 dhe 13 të vendimit.

**2.4.4** Komisioni ka konstatuar më herët se shuma 9,500 euro ka burim krijimi kredinë e papërdorur, e cila nga hetimi ka rezultuar një burim i ligjshëm.

**2.5** Pjesa e mbetur e shumës së dhënë hua është krijuar nga kursimet me burim të ardhurat nga pagat ndër vite.

Bazuar në deklaratimet periodike të subjektit lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të viteve 2006 – 2008, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur me të për secilin vit, nga ku rezultuan balanca pozitive për vitet 2006 dhe 2007 dhe një balancë negative në shumën 222,967 lekë, në vitin 2008. Komisioni konstaton se balanca negative për vitin 2008 ka ardhur nga mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit \*\*\*, pasi si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm, të ardhura këto që për fitimin e realizuar nga shitja nuk janë marrë në analizë. Nëse për një moment do të shkëpusnim nga analiza financiare blerjen e automjetit në vitin 2008, me të ardhurat nga shitja e mjetit të mëparshëm, analiza do të rezultonte me balancë pozitive. Kjo balancë pozitive do të thotë se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi që edhe në vitin 2008 të krijojë kursimet *cash* me të ardhura të ligjshme. Këto kursime *cash* janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit për dhënie hua babait të bashkëshortit në shumën 21,500 euro.

**2.6 Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit,** bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar në lidhje me konstatimin e Komisionit për gjendjen *cash* në vitin 2008, se kursimet prej 400,000 lekësh dhe si shuma prej 5,000 USD, që i kishte dhënë dhuratë vëllai i bashkëshortit dhe familja e tij, janë përfshirë totalisht në krijimin e shumës 21,500 euro. Gjithashtu, është përfshirë edhe shuma e kursyer deri në atë moment përfshirë dhe gjendjen e krijuar të vitit 2008. Gjendje *cash* më 31.12.2008, ka mbetur vetëm shuma 3,000 GBP (konvertuar në 383,000 lekë), ndërsa kursimet e tjera janë përfshirë në shumën e dhënë hua babait të bashkëshortit.

**2.7 Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit në vitin 2008, shitur në vlerën 600,000 lekësh.** Në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e fituara nga shitja, subjekti shpjegon se nuk ka qenë në dijeni të këtij detyrimi dhe për këtë arsye nuk është paguar. Sapo u njoh nga Komisioni, ky detyrim u pagua në datën 21.11.2019. Subjekti në bazë të analizës së përgatitur prej saj, deklaroi se rezultoi me një bilanc pozitiv në shumën 291,477 lekë dhe kërkon nga Komisioni t'i konsiderojë të ligjshme. Pra, këto të ardhura kanë mundësuar krijimin e shumës prej 21,500 euro që u dha hua.

Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit, se mungesa e burimeve të ligjshme të konstatuara nga Komisioni vjen si pasojë e vlerës së konvertuar të gjendjes *cash* për vitin 2008, nuk qëndron. Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shuma 3,000 GBP e dhuruar në vitin 2005 nga vëllai i saj, e llogaritur në analizën financiare sipas kursit të këmbimit të vitit 2005 në shumën 553,950 lekë është konvertuar në vitin 2008 dhe sipas kursit të këmbimit dhe kundërvlehtë e saj në lekë është në shumën 382,980 lekë. Ky pakësim i likuiditetit, i cili ka ardhur për shkak të humbjes nga kursi i këmbimit nuk ka efekt

në analizën financiare, pasi pakësimi i likuiditetit me efekt shtimin e fluksit hyrës të të ardhurave në dispozicion të subjektit ka shkuar për të mbuluar humbjen nga kursi i këmbimit.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mospasjen dijani të detyrimit për pagesën e tatimit për fitimin e realizuar nga shitja e mjetit, Komisioni vlerëson se mospasja dijani nuk e shkarkon nga përgjegjësia. Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>44</sup> ka konsoliduar qëndrimin për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve, duke e konsideruar fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve, për të cilin nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor, si të ardhur të paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme për dhënien hua të shumës 21,500 euro në vitin 2008 (referuar tri burimeve të krijimit të huas) dhe balanca negative për vitin 2008 në shumën 222,967 lekë ka rezultuar nga mosnjohja si të ardhura të ligjshme të fitimit nga shitja e automjetit në vitin 2008 e shumës 350,000 lekë.

**3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*.** Vlera: 600,000 lekë. Pjesa takuese: në bashkëpronësi.

**Burimi i krijimit:** shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 124/200D”, me targa \*\*\*, sipas kontratës së shitjes, datë 29.1.2008<sup>45</sup>.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**3.1** Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*Blerë automjeti tip ‘Benz’, i vitit 1998, në shumën 600,000 lekë*”. Burimi i krijimit nuk është shënuar.

**3.2** DPSHTRr-ja<sup>46</sup> konfirmon pronësinë e automjetit tip “Mercedes-Benz”, viti 1998, me targa \*\*\* (\*\*\*) , në emër të z. K.H., blerë shtetasit S.M. me kontratën e shitblerjes datë 18.11.2008<sup>47</sup>, me çmimin 600,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**3.3** Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie në datën 18.11.2008, duket se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, të përfituara më 29.1.2008, nga shitja e automjetit të mëparshëm në shumën 600,000 lekë.

### **Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të saktë të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, në përputhje me dokumentacionin ligjor.**

**3.4 Analizë automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\***, që ka shërbyer si burim i krijimit për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, viti 1998, me targa \*\*\*

**3.4.1** Në deklaratën e vitit 2003, bashkëshorti i subjektit, z. K.H., ka deklaruar: “*Automjet tip ‘Mercedes-Benz’, blerë në vlerën 250,000 lekë, me burim nga të ardhurat familjare dhe biznesi privat*”. Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*Shitur mjete ‘Benz’, me targa \*\*\*, në shumën 600,000 lekë*”.

**3.4.2** DPSHTRr-ja ka konfirmuar se automjeti me targa \*\*\* ka qenë në pronësi të z. K.H. dhe, më pas, i është shitur z. F.I.

Automjeti rezulton që është blerë në shtetin gjerman nga blerësi I.R. në çmimin 1,200 euro (ose 162,000 lekë me kursin ditor 135 lekë/euro), datë 18.11.2003. Nga dokumenti doganor i datës 26.11.2003 rezulton se për këtë automjet është paguar taksa doganore në shumën

<sup>44</sup> Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019; vendim nr. 34-2019 (JR), datë 2.12.2019.

<sup>45</sup> Kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 29.1.2008.

<sup>46</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2019, nga DPSHTRr-ja konfirmon automjetin me targa \*\*\* (\*\*\*) , në pronësi të z. K.H. dhe automjeti me targa \*\*\* (\*\*\*) ka qenë në pronësi të z. K.H., por tani është tjetërsuar.

<sup>47</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.11.2008.

158,261 lekë. Çmimi total i automjetit është 162,000 lekë + 158,261 lekë, taksa doganore = 320,261 lekë. Me kontratën e shitjes datë 20.1.2004<sup>48</sup> shtetasi I.R. ia shet automjetin tip “Mercedes-Benz”, viti 1990, blerësit K.H. me çmimin 250,000 lekë. Pra, shitësi, pas 25 ditësh që i ka paguar doganën, ia shet automjetin z. K.H. me vlerë 250,000 lekë, me një diferencë prej 70,000 lekësh më pak se ka paguar.

Kontrata e shitjes datë 29.1.2008<sup>49</sup> pasqyron veprimin e shitjes me shitës K.H. dhe blerës F.I. për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, të vitit 1990, me çmimin 600,000 lekë, likuiduar *cash* nga blerësi.

**3.4.3 Komisioni, nisur nga fakti se çmimi i pasqyruar në kontratë mund të mos jetë çmimi real i blerjes, ka kërkuar shpjegime nga subjekti në lidhje me diferencën në çmim.**

Subjekti ka shpjeguar se shitblerja e automjeteve është bërë me kontratë noteriale dhe është regjistruar sipas rregullave shtetërore në fuqi. Blerja e automjetit, sipas bashkëshortit, ka qenë okazion për të dhe ky ka qenë shkak i çmimit të ulët të blerjes, ndërsa çmimi i shitjes jo vetëm që është krejtësisht i përshtatshëm sipas vlerës së tregut, por duhet mbajtur në konsideratë se automjeti është mirëmbajtur, posaçërisht pas vitit 2003 nuk është përdorur thuajse fare për shkak se bashkëshorti ka qenë i punësuar si shofer në gjykatë.

### **3.5 Analiza financiare e burimit të krijimit të shumës 250,000 lekë, përdorur për blerje automjeti në datën 20.1.2004**

**3.5.1** Në deklaratën e pasurisë për vitin 2003, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit datë 20.1.2004, të ardhurat familjare dhe të ardhurat nga biznesit privat.

**3.5.2** Subjekti nuk ka deklaruar kursime për vitin 2003. Të ardhurat familjare nga pagat për periudhën 1.1.2004 - 20.1.2004 janë në shumën 73,808 lekë dhe nuk janë të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

**3.5.3** DRT-ja Kukës nuk ka konfirmuar që z. K.H. të jetë i regjistruar pranë kësaj drejtorie për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

**3.5.4** Komisioni, në pyetësin nr. 4, ka kërkuar nga subjekti të konfirmojë të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar nga bashkëshorti K.H., si dhe të provojë me dokumentacion ligjor realizimin e këtyre të ardhurave dhe nëse janë paguar tatimet përkatëse.

Subjekti ka shpjeguar se për shkak të kohës së largët që ka kaluar, si dhe të problematikave që ka pasur dega e tatim-taksave në vitet e para të funksionimit të saj në Tropojë, e ka të pamundur të paraqesë dokumentacion shkresor për të provuar xhiron qarkulluese dhe fitimin. Të dhënat e xhiros së viteve të kaluara kanë qenë në dosje, por tanimë nuk ekzistojnë. Subjekti shpjegon se aktiviteti privat ka vijuar në mënyrë të pandërprerë deri në momentin e dhënies me qira të ambienteve.

Po kështu, subjekti ka shpjeguar që si provë për të vërtetuar hapjen e biznesit tregtar të bashkëshortit është vërtetimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me anë të të cilit vërtetohet se vendimi për hapjen e biznesit është nr. \*\*\*, datë 18.4.1992, i cili i ka dhënë të drejtën për të ushtruar aktivitetin privat ligjor, gjë që tregon se bashkëshorti i subjektit që në vitet '90, ka ushtruar aktivitet në mënyrë të ligjshme. Subjekti shprehet se për arsye të kohës së largët e ka objektivisht të pamundur gjetjen e të dhënave të tjera në lidhje për sa kërkohet.

---

<sup>48</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 20.1.2004.

<sup>49</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 29.1.2008.

**3.5.5** Komisioni, me pyetësoin nr. 4, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë nëse në pagesën e shumës 40,023 lekë, si të ardhura nga diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes, janë përfshirë ose jo kamatëvonesat dhe gjobat.

Subjekti ka shpjeguar se referuar të dhënave në urdhërpagesë për tatimin e mbajtur në burim datë 21.11.2019, në shumën prej 40,023 lekësh, janë pasqyruar në mënyrë të plotë principlali dhe penaliteti.

**3.6** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit prej 300,000 lekësh (ndërkohë që diferenca sipas kontratave është 350,000 lekë), me vonesë, më 20.11.2019 gjatë procesit të rivlerësimit, për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare;
- ii. subjekti ka paguar detyrimin principal prej 30,000 lekësh (300,000 lekë x 10%) dhe vlerën 10,000 lekë penalitet për mosdorëzimin e deklaratës tatimore në afatin e përcaktuar (detyrimi tatimor është deklaruar për muajin tetor 2019 dhe afati i dorëzimit të deklaratës tatimore është data 20.11.2019, por subjekti e ka dorëzuar në datën 21.11.2019). Vlera prej 10,000 lekësh nuk është penaliteti për mospagesë të detyrimit tatimor ndër vite;
- iii. subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës 250,000 lekë;
- iv. nuk provohen me dokumentacion ligjor të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i bashkëshortit, deklaruar nga subjekti si burim për blerjen e këtij automjeti.

**3.7** Në lidhje me këto konstatime, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës me rezultatet e hetimit dhe, në prapësimet e tij, si dhe në seancë dëgjimore, ka shpjeguar se në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e fituara nga shitja, nuk kanë qenë në dijeni të këtij detyrimi dhe, për këtë arsye, nuk është paguar. Sapo u njohën me këtë detyrim e paguan menjëherë datë 21.11.2019, sipas mandatpagesës së depozituar më herët në Komision. Ndërsa në lidhje me blerjen e automjetit, deklaruar në vitin 2003, fakti që pronësia e bashkëshortit ka kaluar në janar të vitit 2004 nuk vërteton që kjo shumë është paguar atë vit, pasi nga momenti i blerjes dhe deri në nxjerrjen e certifikatës së automjetit duhet një periudhë kohe. Për blerjen e automjetit në shumën 250,000 lekë, janë përdorur kursimet e subjektit nga paga që, siç duket dhe nga analiza, subjekti dhe bashkëshorti deklarojnë se kanë pasur të ardhura të mjaftueshme duke rezultuar me një bilanc pozitiv në shumën 94,297 lekë. Pra, nuk janë përdorur burimet nga qiraja e dyqanit. Subjekti shpjegon se automjetin e kanë pasur në zotërim, vlera e të cilit është likuiduar në mirëbesim në ditët e fundit të dhjetorit të vitit 2003 dhe në fillim të janarit 2004 u formalizua marrëdhënia kontraktore. Pra, edhe logjikisht vlera e blerjes së këtij automjeti, në datën 8.1.2004, nuk mund të përfshihet me të ardhurat e vitit 2004.

**3.8** Komisioni vlerëson se mospasja dijeni e subjektit të rivlerësimit për pagesën e tatimit mbi diferencën e çmimit nuk e shkarkon nga përgjegjësia duke qenë se për transaksione të kësaj natyre detyrimin për pagesën e tatimit mbi diferencën e çmimit e ka personalisht subjekti/personi i lidhur me të.

Pagesa e tatimit me vonesë është bërë për qëllim të procesit të rivlerësimit dhe, si e tillë, e ardhura për të cilën është paguar ky tatim nuk do të merret në konsideratë si e ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit<sup>50</sup>. Në këto kushte, në analizën financiare të vitit 2008 Komisioni nuk ka marrë në analizë fitimin e realizuar nga shitja e automjetit në shumën 350,000 lekë.

<sup>50</sup> Vendimi nr. 11/2019(JR), datë 22.5.2019 për subjektin E. I.

**3.9** Komisioni i gjeti të mjaftueshme dhe bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në janar të vitit 2004, për arsye se automjeti është zotëruar dhe është likuiduar në mirëbesim në ditët e fundit të dhjetorit të vitit 2003 dhe, në fillim të janarit të vitit 2004, është formalizuar marrëdhënia kontraktore.

Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit provohet me deklarinimin e automjetit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, deklaratë në të cilën pasqyrohen pasuritë e krijuara deri më 31.12.2003.

**Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme për të blerë automjetin në shumën 250,000 lekë, në vitin 2003.**

**Komisioni nuk mori në konsideratë të ardhurat e përfituara nga fitimi i realizuar nga shitja e këtij automjeti në vlerën 350,000 lekë, të deklaruara si burim krijimi për blerjen e automjetit, në vitin 2008.**

#### **4. Gjendje *cash* në shumën 1,485,000 lekë, në bashkëpronësi**

**4.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndryshimet e kursimeve *cash*, duke filluar nga viti 2004 e në vazhdim, si dhe ka deklaruar shtesat e kursimeve *cash*, duke specifikuar edhe burimin e krijimit të këtyre shtesave. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar edhe pakësimet duke përcaktuar destinacionin e përdorimit të këtyre shumave. Subjekti, në deklaratën pasurore të vitit 2016, deklaroi si kursime *cash* shumën prej 1,485,000 lekësh. Referuar analizës financiare, gjendja e kursimeve *cash* në datën 31.12.2016 është 1,607,507 lekë.

**4.2** Nga analiza financiare për periudhën 2003 - 2016, subjekti i rivlerësimit duket se ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë, përballuar shpenzimet e kryera dhe për të krijuar kursimet e deklaruara, pasi ka rezultuar me një balancë financiare pozitive me përjashtim të vitit 2008.

**4.3** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se ka mospërputhje të vlerës së deklaruar të kursimeve në shumën 122,507 lekë, referuar deklaratave periodike ku subjekti ka deklaruar shumën totale të kursimeve *cash*, si dhe në deklaratën *Vetting*.

**4.4** Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime të përmbledhura, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se siç ka deklaruar më sipër, gjendja *cash* më 31.12.2008 ishte në shumën 3,000 GBP, e cila u konvertua në shumën 383,000 lekë. Vlera e gjendjes *cash* (në shumën 1,485,000 lekë) në deklaratën *Vetting* është në përputhje me analizën dhe balancën financiare përveç të ndonjë diference të vogël që mund të ketë ardhur nga diferenca në kohë midis datës së deklaratës *Vetting* dhe datës së DIPP-së së vitit 2016.

**4.5** Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me diferencën e gjendjes *cash*, qëndrojnë. Shuma prej 3,000 GBP, e cila është dhuruar në vitin 2005 nga vëllai i subjektit dhe është kursyer *cash* është llogaritur në analizën financiare me kundërvleftën në lekë, sipas kursit të këmbimit të po këtij viti, në shumën 553,950 lekë. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, ka deklaruar se shuma prej 3,000 GBP u konvertua në vitin 2008 dhe, sipas kursit të këmbimit, kundërvlefta në lekë është në shumën 382,980 lekë, duke bërë që gjendja *cash*, në datën 31.12.2016, të jetë në shumën 1,436,537 lekë.

Më tej, në lidhje me pretendimin e subjektit se diferenca mund të ketë ardhur nga diferenca në kohë midis datës së deklaratës *Vetting* dhe datës së DIPP-së së vitit 2016, Komisioni vlerëson se ky shpjegim qëndron, pasi në deklaratën e interesave private periodike të vitit



2016 subjekti deklaroi gjendjen e likuiditeteve deri më 31.12.2016, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi gjendjen e likuiditeteve në datën e plotësimit të kësaj deklaratë.

**Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e dhëna, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar diferencën në gjendjen *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.**

**5. Hua pa afat në shumën 800,000 lekë, dhënë vëllait të subjektit, z. V.I., në vitin 2014**

**5.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për shumën 800,000 lekë, dhënë hua vëllait për arsye familjare e shëndetësore, kursimet *cash* të akumuluar deri në vitin 2014.

**5.2** Sipas analizës financiare të gjendjes *cash*, duket se subjekti ka pasur kursime *cash* të mjaftueshme për dhënien e huas. Duke qenë se analiza financiare për vitin 2014 rezultoi me balancë pozitive duket se këto kursime janë krijuar me burime të ligjshme të ardhurash<sup>51</sup>.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, të ligjshme për dhënien e huas në vlerën 800,000 lekë.**

**6. Hua pa afat në shumën 250,000 lekë, dhënë babait të subjektit, z. A.I., në vitin 2016**

**6.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për shumën 250,000 lekë, dhënë hua babait, kursimet *cash* të akumuluar deri në vitin 2016.

**6.2** Sipas analizës financiare të gjendjes *cash*, duket se subjekti ka pasur kursime *cash* të mjaftueshme për dhënien e huas. Duke qenë se analiza financiare për vitin 2016 rezultoi me balancë pozitive duket se këto kursime janë krijuar me burime të ligjshme të ardhurash.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të mjaftueshme dhe të ligjshme për dhënien e huas në vlerën 250,000 lekë.**

**7. Dhuratë në shumën 3,000 GBP nga vëllai i subjektit, z. K.I., për banesën e re, në shtator të vitit 2006**

**7.1** Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: “3,000 GBP dhuratë nga vëllai K.I., emigrant ekonomik me dokumente në Angli”.

**7.2** Komisioni ka kërkuar nga subjekti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 3,000 GBP.

**7.3** Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale të datës 13.1.2017<sup>52</sup> me deklarues shtetasin K.I., i cili ka deklaruar se: “... në muajin shtator 2006 i kam dhuruar motrës Flora Hajredinaj 3,000 GBP me rastin e hyrjes në shtëpinë e re. Kjo shumë është siguruar nga kursimet e mia, që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në emigracion në Britaninë e Madhe që nga viti 1999”.

**7.4** Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit si dokumentacion provues ligjor, në formën e kërkuar nga ligji (vulë apostile/përkthyer/noterizuar): (i) lejen e hyrjes në shtetin anglez për periudhën 2.3.2005 - 2.9.2005; lejen e qëndrimit për periudhën 8.2005 – 8.2007; (ii) lejen e përhershme të qëndrimit në shtetin anglez, të lëshuar në datën 23.11.2008; (iii) kartën e sigurimit për shtetasin K.I., e cila tregon se ky shtetas përfiton të ardhura të ligjshme dhe paguan kontributet shoqërore në shtetin anglez; (iv) dokumentin e përfitimit të pagës datë 3.11.2016, në shumën *neto* prej 330,70 GBP, e cila nuk është e mjaftueshme për të justifikuar dhurimin subjektit të rivlerësimit në shumën 3,000 GBP.

**7.5** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar nga vëllai K.I. nga puna në

<sup>51</sup> Shihni analizën financiare në f. 31 të vendimit.

<sup>52</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 13.1.2017, me deklarues shtetasin K.I.

emigracion në Angli, në vlerën 3,000 GBP dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk do të merret në konsideratë në analizën financiare.

**7.6 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, pas dërgimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit,** subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se konfirmon ekzistencën e kësaj vlere, marrë dhuratë nga vëllai i saj, por për shkak të kohës së largët është në pamundësi objektive për të siguruar dokumente të tjera, përveç sa ka paraqitur më herët para Komisionit, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Duke insistuar në ligjshmërinë e të ardhurave të vëllait, subjekti kërkon nga Komisioni, që të mbahen në konsideratë parashikimet dhe përmbajtja e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit të përfshihet në analizën financiare. Megjithatë, në vlerësimin e subjektit, edhe nëse kjo vlerë nuk do të përfshihet në analizën financiare, ajo pretendon se nuk ndikon në rezultatin pozitiv të mundësisë së krijimit të të ardhurave të ligjshme për justifikimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, përfshirë vlerën e gjendjes *cash*, si më sipërtrajtuar.

**7.7 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të justifikojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë krijuar shumën 3,000 GBP. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur prova që të vërtetojë pamundësinë objektive për sigurimin e dokumentacionit ligjor, parashikuar në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.**

**8. Dhuratë në shumën 20,000 lekë,** nga motra T.Gj., për banesën e re në vitin 2007

Referuar detyrimit ligjor për deklarimin e dhuratave me vlerë mbi 10,000 lekë, duket se subjekti i rivlerësimit, në f. \*\*\* të deklaratës vjetore të pasurisë për vitin 2007, ka deklaruar në mënyrë të saktë. Në seksionin “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar llojin e dhuratës së përfituar, identitetin e personit që ka dhuruar, si dhe lidhjen me këtë person.

**9. Dhuratë në shumën 20,000 lekë,** nga motrat e bashkëshortit F.H. dhe N.S., për banesën e re në vitin 2007

Referuar detyrimit ligjor për deklarimin e dhuratave me vlerë mbi 10,000 lekë, duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të saktë në f. \*\*\* të deklaratës vjetore të pasurisë për vitin 2007. Në seksionin “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar llojin e dhuratës së përfituar, identitetin e personit që ka dhuruar, si dhe lidhjen me këtë person.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, për pikat 8 dhe 9, ka deklaruar saktë shumat e mësipërme në rubrikën e dhuratave dhe trajtimeve financiare.**

**10. Mbështetje financiare në shumën 670 USD,** nga aktiviteti Pameka në Palermo dhe Trapani, Itali, në korrik të vitit 2014

Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 shumën e përfituar në formën e mbështetjes financiare për vizitën studimore të kryer prej saj në Itali. Kjo mbështetje financiare duket se ka shërbyer për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, të cilat janë kryer në funksion të vizitës studimore.

**Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë deklaram.**

**11. Lokal me sip. 37.16 m<sup>2</sup>, ndërtuar në vitin 1991,** në pronësi të bashkëshortit K.H., në Bajram Curri (me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.8.1993). Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**12. Lokal me sip. 24.28 m<sup>2</sup>, fituar në vitin 1991** nëpërmjet privatizimit nga vëllai S.H. dhe, më pas, blerë nga bashkëshorti i subjektit K.H., në Bajram Curri (sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.7.1993). Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**12.1** Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “ (a) lokal i përfituar nga privatizimi me sip. 20 m<sup>2</sup>, në Tropojë, me vlerë 10,000 lekë; (b) lokal i ndërtuar në vitin 1991, me sip. 35 m<sup>2</sup> me vlerë 20,000 lekë, Tropojë, nga të ardhurat familjare”.

**12.2** ASHK-Zyra Vendore Tropojë<sup>53</sup> ka konfirmuar se në emër të z. K.H. janë të regjistruara pasuritë e llojit “Njësi” me sip. 24.28 m<sup>2</sup> dhe sip. 37.16 m<sup>2</sup>, në Bajram Curri.

**12.3** Pasuria e llojit “Njësi” me sip. 24.82 m<sup>2</sup> është përfituar nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.7.1993<sup>54</sup>, me shitës N.D. dhe blerës K.H. me objekt blerjen e një pjese të lokalit në lagjen “\*\*\*”, përballë kinema “\*\*\*” (përfituar nga ligji i privatizimit), në shumën 100,000 lekë, në Bajram Curri. Pasuria e llojit “Njësi” me sip. 37.16 m<sup>2</sup> është përfituar nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.8.1993, me shitës S.H. dhe blerës K.H. me objekt shitblerjen e një lokali përballë kinema “\*\*\*”, në shumën 100,000 lekë, në Bajram Curri.

**12.4** Pasuritë e mësipërme janë regjistruar në ZVRPP Tropojë sipas vërtetimit hipotekor, datë 23.1.2017 (shtetasi K.H. – njësi shërbimi me sip. 24.28 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “\*\*\*”) dhe sipas vërtetimit hipotekor të datës 23.1.2017, njësi shërbimi me sip. 37.16 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “\*\*\*”, të dyja në Bajram Curri).

**12.5** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka mospërputhje/pasaktësi deklarimi për sa i përket:

- i. vlerës së deklaruar për lokalin me sip. 35 m<sup>2</sup>, deklaruar në vitin 2003, në vlerën 20,000 lekë, ndërsa pasqyruar në kontratën e shitjes, datë 16.8.2003, në vlerën 100,000 lekë;
- ii. referuar sipërfaqes, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 rezulton e deklaruar sip. prej 35 m<sup>2</sup>, ndërsa ASHK-Drejtoria Vendore Tropojë pasqyron sip. prej 37.16 m<sup>2</sup>.

**12.6** Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

**12.7** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se kjo pasaktësi ka qenë pakujdesi në vendosjen e vlerës në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe konfuzioni ka ardhur pasi kjo pasuri është blerë që në vitin 1991 dhe në mungesë të kontratës së shitjes në atë kohë. Subjekti shpjegon se në atë kohë nuk ka qenë në lidhje me bashkëshortin dhe as ka qenë palë në kontratë.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme, ka shpjeguar pasaktësinë në deklarin e vlerës së lokalit, si dhe të sipërfaqes.**

**13. Dhuratë në shumën 5,000 USD** nga kunati S.H., në gusht të vitit 2008, nëpërmjet bashkëshortes së tij, znj. C.L.H. (në formë ndihme në funksion të një ftese për të vizituar vendin e saj në SHBA për mbulim shpenzimesh), deklaruar nga bashkëshorti i subjektit K.H.:

- dhuratë nga bashkëshortët S. dhe C.H. (nëpërmjet MoneyGram, datë 13.2.2012), në shumën 900 USD;
- dhuratë nga bashkëshortët S. dhe C.H. (nëpërmjet MoneyGram, datë 26.12.2015), në shumën 2,300 USD;
- dhuratë nga bashkëshortët S. dhe C.H. (nëpërmjet MoneyGram, datë 8.2.2016), në shumën 2,990 USD;
- dhuratë nga bashkëshortët S. dhe C.H.(nëpërmjet MoneyGram, datë 13.6.2016), në shumën 2,000 USD dhe 871.34 euro.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2019, nga ASHK-Drejtoria Vendore Kukës, Zyra Vendore Tropojë.

<sup>54</sup> Kontrata e shitblerjes është depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

**13.1** Këto shuma janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat vjetore të pasurive në rubrikën “të dhënat konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale” dhe përkatësisht në DPV-të e vitit 2008<sup>55</sup>, 2012, 2015 dhe 2016.

**13.2** Për shumën 5,000 USD, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) kërkesën për aplikim për vizë amerikane nga bashkëshorti dhe njoftimin e datës 24.12.2008, nëpërmjet e-mail-it për caktimin e intervistës në zyrën konsullore të Ambasadës Amerikane në Shqipëri; (ii) deklaratë përkrahjeje para noterit publik të shtetit të New York-ut, datë 8.11.2008, nga znj. C. H., bashkëshortja e kunatit, për ftesë për vizitë drejtuar shtetasve Flora, K. dhe K.H., në të cilën garanton se do të jetë përgjegjëse për qëndrimin e tyre në SHBA.

**13.3** Subjekti i rivlerësimit, për të provuar burimin e ligjshëm të shumave të dërguara dhuratë në vitet 2008, 2012, 2015 dhe 2016 nga familjarët e tyre, ka depozituar dokumentacion ligjor në formën e kërkuar nga ligji (me vulë apostile/noterizuar dhe përkthyer).

**13.3.1** Subjekti ka shpjeguar se shuma prej 5,000 USD është dërguar në Shqipëri në gusht të vitit 2008 nga znj. C.H., deklaruar nga kjo e fundit në një deklaratë<sup>56</sup>.

**13.4** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me shumat 900 USD, 2,300 USD, 2,990 USD dhe 2,000 USD dhe 871.34 euro, i ka deklaruar në deklaratat periodike si tërheqje nga institucioni financiar MoneyGram.

**13.5** Institucioni financiar MoneyGram<sup>57</sup>, në korrespondencën që ka pasur me Komisionin për qëllime të hetimit administrativ, ka konfirmuar tërheqjet e këtyre shumave nga familjarët e subjektit të rivlerësimit.

**13.6** Subjekti i rivlerësimit, si dokumentacion provues ligjor për burimin e shumës 5,000 USD, ka vënë në dispozicion të Komisionit formularin e të ardhurave të shtetasve C. dhe S.H. për vitet 2012 – 2018, në shumën 962,905 USD, sipas formatit 1040 të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme të New York-ut, nga ku rezulton se për të ardhurat e përfituara kanë paguar tatime në shumën 128,638 USD. Formulari i të ardhurave për vitin 2008 për shtetasit C. dhe S.H. provon se këta shtetas kanë përfituar të ardhura *bruto* në shumën 70,593 USD.

**13.6.1** Për shumën 900 USD subjekti ka depozituar formularin e të ardhurave të shtetasve C. dhe S.H. për vitin 2012 në shumën 114,339 USD, sipas formatit 1040 të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme të New York-ut.

**13.6.2** Për shumën 2,300 USD subjekti ka depozituar formularin e të ardhurave për vitin 2015, në shumën 84,602 USD, sipas formatit 1040 të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme të New York-ut.

**13.6.3** Për shumën 2,990 USD subjekti ka depozituar formularin e të ardhurave për vitin për 2016, në shumën 196,458 USD, sipas formatit 1040 të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme të New York-ut.

---

<sup>55</sup> Në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar te të dhënat konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale: “5,000 USD dhuratë sjellë nga kunati im, nëpërmjet bashkëshortes së tij, e cila ishte për vizitë në Shqipëri 1-9 gusht 2008 në shenjë ndihme dhe për një ftesë për të vizituar vendin e saj në një të ardhme të afërt, për mbulim shpenzimesh.

<sup>56</sup> Konkretisht deklarojmë se për vëllain e S. dhe familjen e tij, K.H. ne kemi dërguar fillimisht në gusht të vitit 2008, kur unë kam vizituar Shqipërinë për herë të parë, vlerën 5,000 USD, e cila është lehtësisht e verifikueshme nga sistemi TIMS. Në vitet në vazhdim i kemi dërguar familjes së vëllait të S., dollarë për nevoja familjare. Kam punuar në Citibank në periudhën 1998-2016. Unë dhe S., gjithashtu, zotërojmë një biznes të përgjithshëm ndërtimi që nga viti 2011. Deklaroj se burimi i këtyre shumave është plotësisht i ligjshëm dhe i verifikueshëm nga autoritetet e shtetit tim”.

<sup>57</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2019, nga AK-Invest.

**13.6.4** Për shumën 2,000 USD dhe 871.34 euro subjekti ka depozituar formularin e të ardhurave për vitin 2016, në shumën 196,458 USD, sipas formatit 1040 të Departamentit të Thesarit – Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme të New York-ut.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion ligjor të mjaftueshëm, ku provohet se shtetasit C. dhe S.H. kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe kanë pasur mundësi financiare të dërgojnë shumat e sipërpërmendura subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.**

**14. Depozitë me afat në shumën 3,200 USD, në “Credins Bank” dhe depozitë në shumën 5,000 USD, të bashkëshortit K.H. në “Intesa Sanpaolo Bank”**

**14.1** “Credins Bank”<sup>58</sup> konfirmon depozitën në shumën 3,200 USD, në emër të z. K.H., të depozituar *cash* nga ky i fundit në datën 16.12.2016. “Intesa Sanpaolo Bank” konfirmon<sup>59</sup> depozitën në shumën 5,000 USD, në emër të z. K.H., të depozituar *cash* nga ky i fundit në datën 2.11.2016.

**14.2** Subjekti i rivlerësimit, me pyetësorin nr. 2, ka shpjeguar se burimi i krijimit të këtyre depozitave, rrjedhë e dhuratave në vlera monetare që ka dërguar në vite vëllai, S.H. me bashkëshorten e tij, të ardhura nga puna e ligjshme në SHBA, dërguar nëpërmjet agjencive të transferimit të parave, të cilat i ka deklaruar në deklaratat vjetore përkatëse. Subjekti ka bashkëngjitur dokumentacion ligjor të analizuar si më lart.

**Komisioni nuk ka konstatuar problematika në lidhje me deklarin dhe burimin e krijimit të këtyre depozitave.**

**15. Llogari rrjedhëse në vlerën 301,010 lekë, në “Credins Bank”** (deklaruar nga subjekti i rivlerësimit)

**15.1** “Credins Bank”<sup>60</sup> konfirmon depozitën në shumën 300,420 lekë, në emër të z. K.H., datë 31.12.2016 dhe në datën 16.12.2016 ky shtetas ka depozituar *cash* shumën prej 300,010 lekësh, me burim kursimet e akumuluar.

**15.2** Në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar se në kushtet që nuk mund të mbanin *cash* mbi 1,500,000 lekë jashtë sistemit bankar, janë çelur dhe depozituar në institucionet bankare në emër të bashkëshortit përkatësisht: depozitë me afat dhe llogari rrjedhëse në “Credins Bank” dhe depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Nga analiza financiare për vitin 2016 duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar pasuri, kryer shpenzime dhe për të krijuar kursime.

**Komisioni vëren se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari rrjedhëse.**

## **KONSTATIME TË TJERA**

**16. Pasuri e llojit “truall” me sip. 496 m<sup>2</sup> + ndërtesë me sip. 96 m<sup>2</sup>, e z. T.H., vjehri i subjektit, bashkëdeklarues për legalizim me bashkëshortin e subjektit K.H.**

**Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**16.1** ASHK-Tirana Rurale<sup>61</sup> ka konfirmuar këtë pasuri të regjistruar në emër të z. T.H. Regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në bazë të lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 1.10.2012,

<sup>58</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019, nga “Credins Bank”.

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>60</sup> Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019, nga “Credins Bank”.

<sup>61</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019, nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana - Veri.

lëshuar nga ALUIZNI për sipërfaqen e parcelës ndërtimore me sip. 496 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi 96 m<sup>2</sup> (sip. totale 201.4 m<sup>2</sup> dy kate).

**16.2** Kjo pasuri, fillimisht, është përfituar nga kontrata e datës 26.8.1996 me shitës R.D. dhe blerës T.H. me objekt blerjen e një banese dykatëshe 2+1, me vlerë 2,100,000 lekë. Shuma prej 1,900,000 lekësh është paguar përpara lidhjes së kontratës, ndërsa shuma prej 200,000 lekësh do të paguhet datë 28.2.1997. Nga dosja e legalizimit të kësaj ndërtese figuron formulari i vetëdeklarimit për legalizim objekti i datës 11.9.2006 me vetëdeklarues T. dhe K.H. Pagesat për zyrën e ALUIZNI-t pranë “Credins Bank”, të datës 12.9.2012 janë bërë në emër të shtetasve T. dhe K.H. Gjithashtu, procesverbali i konstatimit datë 25.9.2010, procesverbali i përgatitjes së dosjes datë 23.11.2011 dhe leja e legalizimi pa datë janë në emër të shtetasve T. dhe K.H.

**16.3** Në datën 11.9.2012 z. K.H. ka bërë një deklaratë noteriale te noteri ku deklaroi se: *“Është në proces legalizimi një objekt me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 773 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 96 m<sup>2</sup> në bazë të vetëdeklarimit nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2006. Në momentin e vetëdeklarimit është vendosur, përveç emrit të babait tim T.H., dhe emri im, por në të vërtetë pas blerjes së objektit në vitin 1996 babi im e ka prishur dhe rindërtuar nga e para me shpenzimet e tij. Kërkoj nga zyra e ALUIZNI-t, që legalizimi i sipërfaqes së parcelës dhe objektit të dalë me VKM, objekt 96 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 496 m<sup>2</sup> të bëhet vetëm në emër të babait tim T.H. dhe unë nuk kam asnjë pretendim. Deklaroj se pretendimi im qëndron për pjesën e mbetur të truallit pas procesit të legalizimit të objektit 96 m<sup>2</sup> dhe truallit me sipërfaqe 496 m<sup>2</sup> pretendim që do e ngre në një moment tjetër legalizimi nëse do të ketë”.*

**16.4** Me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 11.10.2012, është legalizuar objekti i banimit \*\*\* kate me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 496 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e ndërtimit 96 m<sup>2</sup> me numrin e kateve dy mbi tokë në emër të z. T.H.

**16.5** Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 2,100,000 lekësh, të përdorura nga vjehri i subjektit për blerjen e banesës \*\*\*katëshe në vitin 1996.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Së pari, ju sqaroj se kjo pasuri është blerë përpara se unë, subjekti, të lidhesha me djalin e T., blerësi i kësaj pasurie. Së dyti, sipas prindërve të bashkëshortit tim T. dhe B.H., vlera prej 2,100,000 lekësh është përballuar nga të ardhura të ligjshme të siguruara nga puna e të gjithë anëtarëve të familjes deri në atë kohë, si dhe të ardhurat e siguruara në emigracion nga S. dhe A. në vitet 1991 –1996. Në lidhje me këto të ardhura ju vë në dispozicion dokumentet që kam mundur të mbledh për atë periudhë”.*

**16.6** Komisioni, me pyetësin nr. 4, ka kërkuar shpjegime nga subjekti në lidhje me arsyen e mospërfshirjes së bashkëshortit në proces legalizimi, duke lënë në këtë proces vetëm vjehrin T.H.

Subjekti, në përgjigje të saj, ka deklaruar se ka qenë zgjedhja e bashkëshortit K.H. të tërhiqej nga praktika e legalizimit, ku motivi kryesor ishte ndihma e dhënë nga vjehri T.H. për blerjen e banesës në Rr. “\*\*\*” në vitin 2006”.

**16.7** Gjithashtu, Komisioni, me pyetësin nr. 4 ka kërkuar shpjegime nga subjekti nëse bashkëshorti K.H. ka investuar në ndërtimin e kësaj banese dhe nëse po sa ka qenë pjesa e investimit e provuar me dokumentacion ligjor.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Për pasurinë në fjalë, nga ana ime nuk ka pasur kontribut për ndërtimin e saj (rikonstruksion, ndryshime të brendshme dhe suvatime të jashtme të objektit) dhe se nuk kam pasur pretendime për ndonjë pjesë takuese. Nuk jam në dijeni dhe nga bashkëshorti nuk mund të jepen shifra për shkak se ka bashkëjetuar me familjen*

*e tij të origjinës para martesës me mua dhe nuk kanë bërë ndarje të kontributit që sillte apo shpenzonte secili”.*

**16.8** Komisioni, me pyetësin nr. 5, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë se ku ka jetuar bashkëshorti dhe vjehtëri gjatë kohës kur shtëpia është prishur dhe rindërtuar më pas.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Bashkëshorti im ka pasur parasysh se te shtëpia është kryer rikonstruksion, ndryshime të brendshme dhe suvatime të jashtme të objektit, të bëra pjesë-pjesë, ndërsa është ruajtur struktura dhe planimetria e saj, si dhe funksioni qoftë edhe pjesërisht i banimit. Shtëpia ka qenë e banueshme pjesërisht. Gjatë rikonstruksionit të brendshëm në katin e parë, shtëpia ka qenë po e banueshme pasi në katin e dytë kishte tri dhoma gjumi dhe kanë jetuar aty”.*

**16.9** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka mosdeklarim të bashkëshortit të subjektit për përfshirjen në proces legalizimi për ndërtesën pa leje në deklaratat periodike të viteve 2006 – 2012.

**16.10** Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar shpjegime dhe të depozitohet prova bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

**16.11** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se për pasurinë në fjalë, bashkëshorti i saj nuk ka pasur kontribut për rikonstruksion, ndryshime të brendshme dhe suvatime të jashtme të objektit dhe se nuk ka pasur dhe as nuk ka pretendime për ndonjë pjesë takuese të këtij objekti në këto rrethana, duke qenë se *de facto* bashkëshorti nuk ka qenë përfitues i kësaj pasurie dhe nuk e kanë konsideruar si detyrim për të deklaruar dhe nuk kanë pasur as qëllim dhe as arsye fshehjen e saj.

**Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se kjo pasuri është blerë nga vjehtëri i subjektit, z. T.H., është rikonstruktuar prej tij personalisht, deklaratën noteriale, datë 11.9.2012, të bashkëshortit të subjektit (para depozitimit të deklaratës *Vetting*), ku konfirmon se blerja dhe rikonstruksioni i ndërtesës janë kryer nga babai, pa kryer ai personalisht asnjë shpenzim, si dhe faktin se leja e legalizimit ka dalë po në emër të vjehtërit të subjektit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me pronësinë reale dhe ligjore të këtij ndërtimi nga momenti i blerjes e deri me regjistrimin e procedurës së legalizimit në ASHK Tiranë.**

## **17. Analiza financiare për periudhën 2003 - 2016**

**17.1** Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhënat e deklarimeve periodike vjetore në ILDKPKI, në deklaratën *Vetting*, në informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse, si dhe në deklaratimet e subjektit. Znj. Flora Hajredinaj ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2003.

**17.2** Nëpërmjet analizës së kryer nga Komisioni është vlerësuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete) dhe shpenzimet e kryera, si vijon:

- të ardhurat nga pagat e dokumentuara për subjektin e rivlerësimit<sup>62</sup> dhe bashkëshortin<sup>63</sup>, të ardhurat nga shitja e pasurive sipas kontratave<sup>64</sup> përkatëse, të ardhurat nga dhurimi<sup>65</sup> për të cilat është provuar burimi i ligjshëm, sipas deklaratave periodike;
- detyrimet bankare<sup>66</sup> sipas kontratave të kredive bankare;
- huat e dhëna nga subjekti i rivlerësimit sipas deklarimeve periodike;
- shpenzimet e jetesës<sup>67</sup> për një familje me 3 anëtarë, shpenzimet e udhëtimit bazohen në raportin nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetësorin standard, pa cenuar standardin e vendosur nga Kolegji në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, shpenzimet për pagesat e kësteve të kredive sipas nxjerrjes së llogarive bankare, shpenzimet e mobilimit<sup>68</sup> sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorë; shpenzimet e shkollimit<sup>69</sup> sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni arsimor dhe dokumentacionit financiar të pagesave;
- pasuritë, ku përfshihen të gjitha pasuritë e paluajtshme<sup>70</sup> dhe të luajtshme<sup>71</sup> në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit. Çdo pasuri është regjistruar në atë datë/vit kur është paguar. Secila nga pasuritë është analizuar në kohën e krijimit të saj. Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e shitblerjeve, deklaratat noteriale, mandatpagesat, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të. Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në krijimin e pasurisë së fundit;
- likuiditetet trajtohen si pjesë e pasurive në një zë të veçantë: gjendjet *cash* dhe llogaritë bankare<sup>72</sup> në fund të çdo viti/datë të analizuar për çdo person të familjes.

**17.3** Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për një vit të caktuar ushtrimor. Rezultati është përlogaritur për çdo vit kalendarik, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total dhe rezulton si shumatore e: të ardhurave + detyrime – shpenzime – pasuri. Mundësia financiare është analizuar për çdo pasuri të krijuar në momentin e pagesës.

**17.4** Komisioni, në përfundim të analizës financiare për subjektin e rivlerësimit, vlerëson se nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe

<sup>62</sup> Vërtetim për periudhën 16.10.1991- 1.9.1992, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

<sup>63</sup> Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë (listëpagesat për këtë periudhë 1995 - 28.2.1997 nuk gjenden pasi janë djegur gjatë trazirave të marsit 1997)/ vërtetim datë 21.10.2016, nga ISSH-ja ( llogaritur paga nga Komisioni sipas legjisllacionit të kohës); vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, nga ISSH-ja; vërtetim datë 12.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë për përmbauesin K. H.; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2016, nga ISSH-ja për periudhën 2.2000 - 10.2000 (llogaritja e pagës *neto* është bërë nga Komisioni); vërtetim për periudhën 19.10.2000 - 19.10.2001, nga ISSH-ja; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2016, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2017, nga AAPSK-ja.

<sup>64</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 29.1.2008.

<sup>65</sup> Deklarata noteriale me nr. \*\*\*, datë 31.10.2016.

<sup>66</sup> Kontrata e kredisë bankare dhe hipotekë me nr. \*\*\*, datë 28.8.2006.

<sup>67</sup> Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së.

<sup>68</sup> Subjekti deklaron se apartamenti është blerë i mobiluar duke e provuar me kontratën e sipërmarrjes dhe deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 14.1.2020, të shtetasit P.C.

<sup>69</sup> Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2018 nga shkolla W. W. për periudhën 2007 – 2018.

<sup>70</sup> Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2006; kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 20.12.2012, me shitës “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës Flora Hajredinaj për apartamentin me sip. 133 m<sup>2</sup>.

<sup>71</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 20.1.2004; kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.11.2008.

<sup>72</sup> Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019, nga “Credins Bank”; shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2019, nga “Raiffeisen Bank”.



shpenzimet e kryera prej saj dhe personave të lidhur me të, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 4,975,925 lekë.

**17.5**Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime dhe për të depozituar prova për të provuar të kundërtën e atyre të referuara në rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

**17.6** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se konfirmon analizën financiare të periudhës 2003 – 2016, me të dhënat e provat e dërguara në datën 10.9.2020, sipas të njëjtës metodologji të përdorur edhe nga Komisioni, prej së cilës del qartazi se në tërësi, si edhe në secilin vit, treguesit financiarë kanë qenë gjithnjë pozitiv se bashkëshortët Hajredinaj kanë pasur aftësi pagueuse për të përballuar të gjitha shpenzimet që kanë bërë edhe për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, edhe në deklaratat vjetore të dorëzuara në ILDKPKI.

Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësime dhe në seancë dëgjimore, mori në konsideratë dhurimin e shumës 40,000 euro nga babai i bashkëshortit të subjektit, si dhurim i krijuar me të ardhura të ligjshme.

Komisioni, pasi rishikoi analizën financiare për periudhën e hetimit 2003 – 2016, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësime dhe në seancë dëgjimore, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasuri në shumën totale prej -222,967 lekësh.

#### **Analiza financiare e rishikuar për periudhën 2003 - 2016**

<b>Viti</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>Detyrime</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>Pasuri</b>	<b>Rezultati</b>
2003	626 189	0	281 892	250 000	<b>94 297</b>
2004	1 214 376	0	281 892	500 000	<b>432 484</b>
2005	6 229 824	0	328 671	5 752 511	<b>148 642</b>
2006	1 355 757	5 000 000	499 817	5 687 935	<b>168 004</b>
2007	1 525 580	0	900 067	380 482	<b>245 032</b>
2008	2 077 926	-2 648 424	967 966	-1 315 497	<b>-222 967</b>
2009	1 465 426	0	699 751	467 183	<b>298 492</b>
2010	1 821 887	0	1 294 387	-116 537	<b>644 037</b>
2011	1 955 468	0	966 021	593 845	<b>395 602</b>
2012	1 912 169	0	962 182	478 253	<b>471 734</b>
2013	1 716 759	2 648 424	1 059 412	2 760 653	<b>545 118</b>
2014	2 125 631	-800 000	1 251 756	-357 936	<b>431 811</b>
2015	2 456 713	0	1 350 462	533 200	<b>573 051</b>
2016	2 918 976	-250 000	1 332 159	600 742	<b>736 075</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**18.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, i deklasifikuar plotësisht (me raportin nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2020, dërguar në Komision) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se: *“Për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”.*

Për sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj.

**18.1** DSIK-ja ka dërguar në Komision, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2020, raportin e rishikuar dhe të deklasifikuar pjesërisht (raportin nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2020) për kontrollin e figurës, ku evidentohet se: Për subjektin e rivlerësimit, autoritetet verifikuese, *“... disponojnë të dhëna të viteve 2003 dhe 2004, ku ngrihen dyshime se Flora A. Hajredinaj ka favorizuar kundrejt mitës disa persona në proceset gjyqësore, konkretisht: (i) shtetasin \*\*\*\*, të cilit i ka dhënë të drejtën që të dëmshpërblehet; (ii) ka ushtruar ndikim të paligjshëm për të favorizuar \*\*\*\* me qëllim përfitimin e pensionit; (iii) ka favorizuar shtetasin \*\*\*\*, i cili ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër; (iv) ka favorizuar shtetasin \*\*\*\*, i proceduar penalisht për kontrabandë. Gjithashtu ka dyshime se sekser në disa nga këto çështje gjyqësore ka qenë bashkëshorti i Flora Hajredinaj, shtetasi K.H.”.*

**18.2** Për sa më sipër: (1) bazuar në parashikimet e bëra në Aneksin e Kushtetutës “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pika 2, e nenit DH, nisur nga të dhënat e sipërcituara, veprimtaria e dyshuar për veprime korruptive e abuzive me detyrën për subjektin e rivlerësimit i përket një periudhe para afatit, datë 1.1.2012; (2) informacionet që disponohen në ngarkim të saj për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, për një periudhë relativisht të gjatë kohe, në më shumë se një rast, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën e saj funksionale, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit person me tendenca për përfshirje në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga struktura kriminale; (3) bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (4) mbi bazën e të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për raste të mundshme të premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer apo moskryer një veprim, që lidhet me detyrën e saj funksionale, gjatë fazës së gjykimit të një çështjeje penale, marrëdhënia korruptive e vendosur mes saj dhe palës tjetër, që mund të jetë një person nën hetim, gjykim apo një “person i lidhur me të”, është një marrëdhënie apo një kontakt i papërshtatshëm, në papajtueshmëri të plotë me detyrën e saj funksionale; (5) Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës, nga subjekti i rivlerësimit, znj. Flora A. Hajredinaj.

**18.3** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konkluzionin e raportit të dytë të dërguar nga DSIK-ja, ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“... nuk janë kryer verifikimet minimale për vërtetësinë e informacionit, si dhe është mbështetur në të dhëna të paligjshme sepse ka marrë në konsideratë denoncime të rreme për periudha të hershme duke i atribuuar fakte dhe rrethana tërësisht të pavërteta. Kjo përforcohet dhe nga fakti që pas dy vjetësh të raportit të parë, DSIK-ja përpilon*

*raport të dytë me të dhëna të dyshuara në ngarkim të subjektit për vitet 2003-2004, ndërkohë që për periudhën para vitit 2004 unë dhe kolegët e mi jemi verifikuar thellësisht nga organet kompetente të asaj kohe kur kemi filluar të Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Quartazi duket që ky raport nuk përmban asnjë të dhënë të besueshme, objektive prove apo fakt, pa thënë asgjë konkrete, pa referuar në një rast konkret, pa burim prove të besueshëm, pa përmendur se çfarë veprimi kam bërë unë, a jam takuar me ata persona, a kam qenë unë gjyqtar në çështjet penale/civile që përmenden në këtë informacion dhe a kam dhënë unë vendime favorizuese, kush janë këto persona që lidhen me këto njohje me mua apo familjarët e mi, a jam takuar unë ndonjëherë me këto persona, kur është realizuar kontakti i papërshtatshëm imi apo i familjarëve të mi.”*

**18.3.1** Gjithashtu, subjekti shpjegon se rrethanat e pavërteta të raportit të DSIK-së edhe po të kishin baza minimale, nuk do të mund të kualifikoheshin në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga hetimi i Komisionit nuk është provuar, madje nuk ka pasur asnjë *indicie* që të ketë pasur ndonjëherë, edhe para vitit 2004, kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

**18.3.2** Komisioni, nisur nga të dhënat e raportit të dytë të dërguar nga DSIK-ja, ka kryer hetime të mëtejshme, të cilat janë pasqyruar në rubrikën e vlerësimit profesional, ku janë vlerësuar disa çështje gjyqësore dhe, në përfundim të hetimit, nuk ka konstatuar problematika që lidhen me figurën sipas raportit të DSIK-së.

## **19. Në lidhje me çështjen e refuzimit të vizës nga Ambasada Amerikane**

**19.1** Komisioni ka konstatuar se në deklaratën për kontrollin e figurës, në pjesën 5 “Të dhëna për sigurinë” në germën “g” te pyetja “Gjatë 10 vjetëve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s”, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar “jo”.

**19.2** Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me faktin e mosdeklarimit të refuzimit të vizës në deklaratën e kontrollit të figurës.

**19.3** Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se ka aplikuar së bashku me bashkëshortin për t’u pajisur me vizë turistike në Ambasadën Amerikane, pasi kishin marrë ftesë nga bashkëshortja e kumatit të saj, znj. C.H., shtetase amerikane, që të shkonin t’i vizitonin në SHBA, pasi u kishte dërguar dhe garancinë e saj shkretores. Pasi u paraqit për intervistë së bashku me bashkëshortin në ambasadë nuk janë pajisur me vizë. Nuk rezulton se ka pasur specifikime, por në lidhje me arsyen që u dha u është thënë se “nuk kanë treguar lidhje të forta sociale dhe ekonomike me vendin e tyre”.

**19.3.1** Subjekti shpjegon se mosdhënia e vizës ose refuzimi i dhënies së vizës në vitin 2009, nuk është pasqyruar prej saj në deklaratën e kontrollit të figurës sepse ky ka qenë një fakt që nuk përfshihej në të dhënat që duhet të deklaroheshin në këtë deklaratë dhe nuk ka qenë e detyrueshme që të deklarohet sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në pjesën e pestë të kësaj deklarate, pyetja ka këtë përmbajtje shprehimisht: “Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në shtet të BE/NATO-s?”. Nga subjekti është perceptuar se refuzimi i dhënies së vizës dhe refuzimi i vizës janë koncepte të ndryshme.

Subjekti deklaroi se nuk ka qenë ndonjëherë e pajisur me ndonjë lloj vize nga Ambasada Amerikane që, më pas t’i jetë refuzuar ose revokuar.

**19.3.2** Gjithashtu, subjekti mbetet i qëndrimit se refuzimi i vizës ose mosdhënia e vizës nënkupton mospajisjen me vizë të aplikantit nga Ambasada Amerikane për arsye se janë në diskrecion të nëpunësit konsullor dhe që nuk kanë të bëjnë me sigurinë e personit apo me problemet e ligjit që ai mund të ketë. Ndërsa, refuzimi i vizës, sipas kërkesës së formularit,

nënkupton se personi është pajisur më parë me një vizë nga ndonjë ambasadë dhe për arsye që kanë të bëjnë me sigurinë e personit ose për shkak se ai ka probleme me ligjin ose sepse nuk ka respektuar kushtet e vizës, kjo vizë i hiqet ose i refuzohet këtij personi nga shteti përkatës. Pra, refuzimi i dhënies së vizës është koncept totalisht i ndryshëm nga refuzimi i hyrjes në SHBA dhe kjo ka qenë arsyeja që subjekti nuk e ka deklaruar mosdhënien e vizës së vizitorit nga Ambasada Amerikane më 14.1.2009.

**19.3.3** Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës për të dhënë shpjegime në lidhje me refuzimin e vizës, ka paraqitur si provë një e-mail të datës 16.6.2020, ku ka komunikuar me z. A.Z. (Shef i Hetimeve Penale) në Ambasadën Amerikane në Tiranë, i cili, ndër të tjera, ka shkruar se: *“... një zyrtar konsullor ka vetëm disa minuta për të vendosur nëse do të lëshojë një vizë apo jo dhe shumë herë vendimi për të mos lëshuar bazohet në përcaktimin e tij/saj që aplikanti të mos kualifikohet bazuar në të ardhurat, lidhjet me vendin ose një numër rrethanash që nuk janë të natyrës negative, ka një ndryshim në refuzimin e lëshimit të vizës nga një seksion konsullor i ambasadës dhe refuzimin për të lejuar dikë të hyjë në SHBA. Ka njerëz të cilëve u është lëshuar viza nga një ambasadë e seksionit konsullor, por më pas u refuzohet hyrja në kufirin tokësor/detar/ajror nga personeli i Doganave të Mbrojtjes së Kufirit. Ky sistem është i ndryshëm në vende të tjera, ku refuzimi për të lëshuar vizë nga një ambasadë është i njëjti me refuzimin për të lejuar hyrjen në një vend, por në SHBA kemi një ndryshim të dukshëm”*.

Gjithashtu, subjekti sjell në vëmendje se edhe në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar faktin e kontributit/dhurimit të kumatit dhe bashkëshortes të shumës prej 5,000 USD, si ndihmë dhe ftese për të vizituar vendin e saj (SHBA) në një të ardhme të afërt, për mbulim shpenzimesh.

**19.4** Në kuadër të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor të plotësojë dhe të dorëzojë personalisht formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, duke e plotësuar me saktësi dhe në përputhje me parashikimet e pjesës 5, të germës “g”, të shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni vlerëson se në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, deklarimi i pamjaftueshëm për të cilin prezumohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, për sa i përket kriterit të figurës, ka të bëjë jo vetëm me mosplotësimin fizik dhe me saktësi të deklaratës së kontrollit të figurës, por edhe me plotësimin me vërtetësi të saj. Mosdeklarimi me vërtetësi i fakteve e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së këtyre fakteve.

Në rastin konkret, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* “dhuratë kunati e familja e tij S.H., nëpërmjet bashkëshortes së tij C.L.H., në gusht të vitit 2008 (në formë ndihme, si edhe në funksion të një ftese për të vizituar vendin e saj, SHBA, për mbulim shpenzimesh, shuma 5,000 USD). I njëjti deklarim është bërë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2008.

Nga sa më lart, Komisioni arrin në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të jenë demonstruar veprime a mosveprime që kanë pasur si qëllim fshehjen e faktit të mosdhënies së vizës nga Ambasada Amerikane në Shqipëri, përkundrazi, të dhënat e mësipërme dëshmojnë se nëpërmjet deklarimit të dhuratës në shumën 5,000 USD, subjekti e ka deklaruar dhe destinacionin e përdorimit të kësaj dhurate për të arritur qëllimin e saj për të vizituar SHBA-në dhe, natyrisht, elementi kryesor për përmbushjen e këtij qëllimi do të ishte, pikërisht, pajisja me vizë nga Ambasada Amerikane.

Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson, gjithashtu, se nuk ndodhet përpara faktit të refuzimit të një vize, por të refuzimit të dhënies së vizës për subjektin, veprim ky që nuk rezulton të ketë ardhur për shkaqe që kanë të bëjnë me figurën e subjektit, gjë që do të krijonte bindjen se subjekti e ka fshehur këtë fakt.

Mosdeklarimi, në deklaratën e kontrollit të figurës, i mosdhënies së vizës nuk shihet si veprim i qëllimshëm i subjektit për të fshehur elementë që do të çonin në cenimin e figurës së tij, por mosdhënia e një vize për qëllime turizmi nuk barazohet me faktin e refuzimit të hyrjes në një shtet të BE/NATO-s dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë në deklaratën e kontrollit të figurës.

Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ i kryer, si dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë përfshirjen e subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj në raste korruptive, si dhe që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, nuk u konstatuan mangësi nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës. Pas hetimit të kryer nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**C.1** Grupi i Punës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hartuar raportin me nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2019, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj.

**C.2** Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit sipas të cilit subjekti Flora Hajredinaj ka treguar aftësi të mira në drejtim të:

- a. aftësi profesionale, ku përfshihen njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor;
- b. aftësi organizative, ku përfshihen aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar dosjet;
- c. etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, ku përfshihen etika në punë, integriteti dhe paanësia;
- d. aftësi personale dhe angazhimit profesional, ku përfshihen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për t’u angazhuar.

## **20. Grupi i Punës në KLGJ ka analizuar tri dokumentet e paraqitura nga subjekti për procesin e rivlerësimit dhe, konkretisht:**

**20.1** Dokumenti nr. 1 – vendimi nr. \*\*\*, datë 13.10.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë<sup>73</sup>, ku subjekti ka gjykuar në një trupë gjykuese dhe ka qenë në cilësinë e kryesueses nga Grupi i Punës në KLGJ nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me aspektin profesional.

**Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me këtë dosje gjyqësore.**

---

<sup>73</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 13.10.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që i përket Prokurorisë për Krime të Rënda kundër të pandehurve R. Sh., A. K., Sh. H., E. D., D. Q. dhe A. Sh., të akuzuar për veprën penale “trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

**20.2** Në dokumentin nr. 2 – vendimi nr. \*\*\*, datë 1.6.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë<sup>74</sup> dhe në dokumentin nr. 3 – vendimi nr. \*\*\*, datë 14.7.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë<sup>75</sup>, ku subjekti ka gjykuar në trupë gjykuese dhe ka qenë në rolin e kryesuesit, Grupi i Punës në KLGJ ka konstatuar se për të dyja këto vendime, gjykimi ka zgjatur jashtë afatit standard 12- mujor të gjykimit të përcaktuar nga germa “f”, e pikës 5, të vendimit të KLD-së, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

**20.3** Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se për vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2016, dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 14.7.2016, kohëzgjatja e gjykimit ka ndodhur për shkak të mosnjoftimit të të pandehurve nga policia gjyqësore, mungesa e letërporosisë, mosparaqitja e mbrojtësve për të cilët është kërkuar marrja e masave disiplinore, mosparaqitja e një anëtarit trupe, mosparaqitja e prokurorëve dhe nga fashikuj voluminozë me shumë dëshmitarë etj. Subjekti, në cilësinë e provës, ka depozituar procesverbalet e seancave gjyqësore të dosjeve përkatëse dhe shpjegon se kjo kohëzgjatje nuk ka ndodhur për shkak të vullnetit të trupit gjykues apo sjelljes së tij dhe se ndonëse gjykimi ka zgjatur 13 muaj e 14 ditë nuk është cenuar parimi i procesit të rregullt ligjor për gjykimin e të pandehurve.

**20.4** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe dokumentacionin e dosjeve përkatëse, vëren se shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ardhur jo për shkaqe subjektive të trupës gjykuese, por për arsye objektive të listuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të pasqyruara në aktet e dosjeve gjyqësore.

**Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe të mbështetura në provat përkatëse, duke mos konstatuar elementë që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit, të cilat mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional.**

## **21. Grupi i Punës në KLGJ ka analizuar pesë dosjet e përzgjedhura me short**

**21.1** Në tri dosje gjyqësore, konkretisht: dosja nr. 2, që i përket çështjes penale nr. \*\*\* regj. them., datë 2.4.2015 regjistrimi<sup>76</sup>; dosja nr. 3, që i përket çështjes penale nr. \*\*\* regj. them., datë 31.7.2015 regjistrimi<sup>77</sup> dhe dosja nr. 5, që i përket çështjes penale nr. \*\*\* regj. them., datë 20.5.2015 regjistrimi<sup>78</sup>, ku subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në trup gjykues me 5 gjyqtarë dhe

---

<sup>74</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 1.6.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që i përket Prokurorisë për Krime të Rënda kundër të pandehurve Q. Gj. dhe Gj. H., të akuzuar për veprën penale “trafikim i personave të rritur në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 110/a/4 e Kodit Penal.

<sup>75</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 14.7.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, që i përket Prokurorisë për Krime të Rënda kundër të pandehurve J. S., A. M., G. M., N. Gj., M. M., A. M. dhe I. K., të akuzuar për veprën penale “sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e një vrasjeje, në bashkëpunim”, të parashikuar nga nenet 80 dhe 25 të Kodit Penal.

<sup>76</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 2.4.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me objekt “vleftësim arresti në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj të dyshuarit B. K. për veprën penale “shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të parashikuar nga nenet 109/b/1 dhe 25 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 3.4.2015.

<sup>77</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 31.7.2015 regjistrimi, që i përket të pandehurit O. P., akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikim të narkotikëve”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 22 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.9.2015.

<sup>78</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 20.5.2015 regjistrimi, që i përket të pandehurit B.N., akuzuar për kryerjen e veprave penale “trafikim të narkotikëve, në bashkëpunim, mbetur në tentativë”, të parashikuar nga nenet 283/a/1, 22 dhe 25 të Kodit Penal dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.4.2016.

ka qenë në rolin e kryesueses, nga analizimi i tyre nga KLGJ-ja, si edhe nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

### **Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk u konstatua ndonjë problematikë në lidhje me këto dosje gjyqësore.**

**21.2** Në dy dosjet e tjera dhe konkretisht: dosja nr. 1, që i përket çështjes penale nr. \*\*\* regj. them., datë 23.6.2014 regjistrimi<sup>79</sup> dhe dosja nr. 4, që i përket çështjes penale nr. \*\*\* regj. them., datë 8.4.2015 regjistrimi<sup>80</sup>, nga Grupi i Punës në KLGJ është evidentuar cenimi i këtyre vendimeve nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe konkretisht:

**21.2.1** Për dosjen nr. 1, çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 23.6.2014 regjistrimi, Prokuroria e Krimeve të Rënda në konkluzionet e saj ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit E. L. për veprën penale “trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë sipas neneve 283/a/1-22 të Kodit Penal dhe dënimit të tij me 7 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri E. L. të dënohet me 4 vjet e 8 muaj. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin e saj ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit E. L., i akuzuar për veprën penale “trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimit me 8 vjet burgim, duke ulur 1/3 sipas nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale e dënon përfundimisht me 5 vjet e 4 muaj burgim. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* , datë 5.11.2014, ka vendosur: *lënien në fuqi të vendimit për fajësinë dhe kualifikimin ligjor, ndryshimin e vendimit për masën e dënimit me 7 vjet burgim, duke ulur 1/3, dënimi përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim.*

Arsyeja e cenimit të vendimit: në caktimin e masës së dënimit me burgim nuk janë përllogaritur saktësisht kriteret e përcaktuara nga nenet 47 dhe 23 të Kodit Penal, ndaj masa e dënimit duhet zbutur drejt minimumit të parashikuar nga dispozita e nenit 283/a/2 të Kodit Penal.

**21.2.1.1** Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me këtë konstatim, e cila ka shpjeguar, ndër të tjera, se cenimi i vendimit është bërë vetëm për sa i përket masës së dënimit dhe vetëm në bazë të bindjes së brendshme të Gjykatës së Apelit, pasi ky cenim i diferencës në masën e dënimit nuk është bërë për shkak të mosllogaritjes saktësisht të kriterëve të neneve 47 dhe 23, por sipas bindjes së brendshme juridike të gjyqtarit dhe Gjykata e Apelit në asnjë moment nuk është shprehur se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në konsideratë kriteret e neneve 47 dhe 23, përkundrazi, Gjykata e Apelit ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë i ka argumentuar të gjitha kriteret e listuara në nenin 47 të Kodit Penal.

**21.2.1.2** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota. Pas analizimit të dokumentacionit të dosjes, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit bashkë me trupën gjyqësore ka dhënë masën e dënimit në përputhje me dispozitat e nenit 232/a/1 të Kodit Penal, si dhe në aplikim të kriterëve ligjore të parashikuara në nenet 47 dhe 23 të Kodit Penal. Cenimi i vendimit nga Gjykata e Apelit ka ardhur si rezultat i bindjes juridike të brendshme të

---

<sup>79</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 23.6.2014 regjistrimi<sup>79</sup>, që i përket të pandehurit E. L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikim të narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 22 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. \*\*\* , datë 15.9.2014.

<sup>80</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 8.4.2015 regjistrimi, që i përket të pandehurit Gj. Q., akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje për gjakmarrje” mbetur në tentativë, “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuar nga nenet 78/a – 25, 22, 278/5 dhe 280 të Kodit Penal; të pandehurit L. Q., akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje për gjakmarrje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga nenet 78/a – 25, 22 dhe 278/5 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\* , datë 26.1.2016.

gjyqtarëve që kanë vlerësuar vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, por jo për shkelje procedure nga kjo e fundit.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me këtë rast, duke mos konstatuar elementë që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit, që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional.**

**21.2.2** Për dosjen nr. 4, çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 8.4.2015 regjistrimi, Prokuroria ka kërkuar: deklarin fajtor të të pandehurit Gj. Q. për veprën penale “vrasje për gjakmarrje”, e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78/a, 25 e 22 dhe dënimin e tij me 30 vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit Gj. Q. për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve në mjedise publike”, parashikuar nga neni 278/5 dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim; në aplikim të bashkimit të dënimeve, dënimin e të pandehurit Gj. Q. me 35 vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit L. Q. për veprën penale “vrasje për gjakmarrje”, e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78/a, 25 e 22 dhe dënimin e tij me 30 vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit Gj. Q., për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve në mjedise publike”, parashikuar nga neni 278/5 dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në aplikim të bashkimit të dënimeve, dënimin për të pandehurin L. Q. me 35 vjet burgim.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur: deklarin e pafajshëm të të pandehurit GJ. Q., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje për gjakmarrje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga nenet 78/a, 25, 22 dhe 278/5, pasi nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet; deklarin fajtor të të pandehurit Gj. Q. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim; deklarin e pafajshëm të të pandehurit L. Q., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje për gjakmarrje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga nenet 78/a, 25, 22 dhe 278/5, të Kodit Penal, pasi nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale që akuzohet, duke urdhëruar lirimin e tij nga paraburgimi nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit për fajësinë dhe masën e dënimit për të pandehurin GJ. Q., për akuzën e mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive. Ndryshimin e vendimit si më poshtë; deklarin fajtor të të pandehurit GJ. Q., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje për gjakmarrje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe dënimin e tij me 23 vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit L. Q., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje për gjakmarrje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga nenet 78/a, 25, 22 dhe 278/5 të Kodit Penal dhe dënimin me 21 vjet burgim; lënien në fuqi për pjesët e tjera të vendimit.

Arsyeja e cenimit të vendimit: në vlerësim të shkaqeve që vepra penale e vrasjes për gjakmarrje ka mbetur në tentativë shihet e nevojshme ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligja sipas neneve 23 dhe 47/2 të Kodit Penal, pasi dispozita e kësaj vepre penale (vrasja për gjakmarrje) kërkon edhe pasojë konkrete (vrasjen e personit).

Kundër vendimit është ushtruar rekurs nga të pandehurit në Gjykatën e Lartë dhe rezulton të jetë e pa gjykuar.

**21.2.2.1** Komisioni, në lidhje me këtë konstatim, ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

**21.2.2.2** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar, ndër të tjera, se ky ishte vendim i marrë nga trup gjykues me 5 anëtarë dhe në përfundim të



shqyrtimit gjyqësor me procedurë të zakonshme, ku pasi janë marrë një sërë provash me dëshmitarë, u gjykua që nuk provohej autorësia e veprës penale. Asnjë prej dëshmitarëve nuk dëshmoi gjatë procesit gjyqësor se të pandehurit të ishin autorët e vrasjes së mbetur në tentative. Madje as i dëmtuari N. P. nuk e konfirmoi këtë fakt në seancë. Qëndrimi i tij ka qenë konsensual (është pyetur më shumë se një herë) në tërësi të deklarimeve të tij. Nuk është gjendur dhe sekuestruar as arma e krimit dhe asnjë tregues tjetër i mangët në drejtim të zbulimit të autorësisë së ngjarjes. Janë mbajtur dy procesverbale të këqyrjes së vendit të ngjarjes në kohë të ndryshme dhe nuk është përfituar asgjë e rëndësishme për ngjarjen. Në përmbajtje të kësaj dosje nuk rezulton që të jetë refuzuar ndonjë kërkesë për marrjen e provave të prokurorit apo të jetë kufizuar e drejta e tij për debatin e provave në seancë gjyqësore. Në përfundim të gjykimit, trupa gjykuese vlerësoi se nuk ka as prova dhe as *indicie* të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, që të japin njoftime tej çdo dyshimi të arsyeshëm ashtu siç e kërkon ligji procedural penal dhe bazuar në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale çdo dyshim për akuzën duhet të çmohet në favor të të pandehurve. Referuar arsytimit të vendimit, Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda nuk rezulton me çelje të hetimit gjyqësor, por ka vendosur mbi baza të bindjes së brendshme mbi të njëjtat prova.

**21.2.2.3** Komisioni, pasi ka analizuar edhe dokumentacionin e dosjes edhe shpjegimet, vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota. Vendimi i dhënë nga trupa gjykuese e kryesuar nga subjekti është vendimmarrje e përbashkët e 5 gjyqtarëve dhe jo vetëm e subjektit të rivlerësimit si gjyqtar i vetëm. Trupa gjykuese ka vlerësuar të gjitha rrethanat, faktet dhe provat gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe ka arritur në përfundim me marrjen e këtij vendimi. Vendimi i Gjykatës së Apelit nuk referon shkelje të kryera nga gjykata e shkallës së parë apo mangësi në veprimet procedurale, që duhet të kryheshin nga kjo e fundit. Nga Gjykata e Apelit nuk është bërë riçelje hetimi si pasojë e një hetimi të mangët nga gjykata e shkallës së parë. Vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë si rrjedhojë e një vlerësimi ndryshe të provave, fakteve dhe rrethanave apo thënë ndryshe, i udhëhequr nga bindja e brendshme e trupës gjykuese të apelit.

**Komisioni vlerëson se cenimi nga Gjykata e Apelit i vendimit të dhënë prej Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ku pjesë e trupës gjykuese është edhe subjekti i rivlerësimit, ka të bëjë me vlerësimin e çështjes nga Gjykata e Apelit ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, gjë për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 72<sup>81</sup> të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke mos konstatuar problematikë që mund të çojë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin profesional.**

#### **Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së**

**22.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Flora Hajredinaj është paraqitur gjithsej një ankesë (në vitin 2014) në Inspektoratin e KLD-së. Ankesa është verifikuar, bazuar në raportin periodik të kryetarit për vendimet e cenuara dhe i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik.

**22.1** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Flora Hajredinaj, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

---

<sup>81</sup> “4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektesinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

## Të dhëna burimore nga Prokuroria

**23.** Sektori i Protokollit dhe Arkivit pranë Prokurorisë së Përgjithshme<sup>82</sup> ka konfirmuar se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj.

**23.1** Drejtoria e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënive me Shërbimin Informativ<sup>83</sup> pranë Prokurorisë së Përgjithshme konfirmon se nuk ka të dhëna që për subjektin Flora Hajredinaj të ketë të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së saj në kontakte të papërshtashme.

**23.2** Sekretaria Sekrete<sup>84</sup> pranë Prokurorisë së Përgjithshme konfirmon se për subjektin Flora Hajredinaj nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve ndaj saj.

**23.3** Prokuroritë e rretheve gjyqësore konfirmojnë se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj.

## KONSTATIME TË TJERA

**24.** Komisioni ka kryer hetime në lidhje me dyshimet e ngritura nga organet e verifikimit dhe për këtë qëllim ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër<sup>85</sup>, ku ka kërkuar informacion dhe dosjet përkatëse në lidhje me disa çështje gjyqësore.

**24.1** Në dy çështje gjyqësore që janë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, dhe konkretisht, dosja gjyqësore nr. \*\*\*, datë 17.12.2003, me të pandehur E.N. për veprën penale “lidhja e paligjshme e energjisë”<sup>86</sup> dhe dosja gjyqësore nr. \*\*\*, datë 22.12.2003, me paditës S.M. dhe i paditur Drejtoria Vendore e Policisë Dibër në lidhje me marrëdhënie punësi<sup>87</sup>, Komisioni, pas analizimit të dosjeve, nuk ka konstatuar problematika që lidhen me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

**24.2** Në tri çështje gjyqësore dhe konkretisht në dosjen gjyqësore me palë F.I. me objekt “korrigjim datëlindjeje”<sup>88</sup>, dosjen gjyqësore të vendimit për dhënie masë sigurimi e vitit 2003

<sup>82</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2019.

<sup>83</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2019.

<sup>84</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2019.

<sup>85</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>86</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vënë në dispozicion dosjen gjyqësore me të dhënat: Kërkues-Prokuroria e Rrethit Dibër, i pandehur E.N., i akuzuar se ka kryer veprën penale të lidhjes së paligjshme të energjisë, vepër e parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal etj. Çështja është gjykuar nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, ku Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka tërhequr akuzën dhe kërkon kalimin e akteve në Prokurori sipas nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale çështja duhet t'i kthehet organit të akuzës sipas kërkesës së prokurorit në seancën gjyqësore. Gjykata ka vendosur kalimin e akteve të prokurorit të çështjes penale nr. \*\*\*, në ngarkim të të pandehurit E.N.

<sup>87</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër konfirmon se nuk është gjendur dosja me nr. \*\*\*, datë 22.12.2003, me paditës S.M., por u gjend ajo e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.12.2003, me paditës S.M. Çështja është gjykuar nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, me të dhënat: paditës S.M., i paditur Drejtoria e Policisë Qarkut Dibër, me objekt-shfuqizim i urdhrin nr. \*\*\* të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Dibër si të pabazuar në ligj. Rikthimin në punën e mëparshme, shpërblimin e pagës për kohën e mbetur padrejtësisht në punë deri 12 muaj. Gjykata, në vendimin e saj, ka vendosur: pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur Drejtorisë së Policisë së Qarkut Dibër të dëmshpërblejë paditësin S.M. me 12 paga mujore. Rrëzimin e kërkesës për rikthimin e paditësit në punën e mëparshme si të pabazuar në ligj. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.11.2004, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 22.12.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

<sup>88</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër konfirmon se nga verifikimet e bëra nuk u arrit të gjendej dosje me palë dhe objekt të tillë, por nga verifikimi rezultoi çështja civile me kërkuese F.I. me objekt: “vërtetim fakti juridik të qenies në marrëdhënie pune me

për të ndaluarin Sh.D.<sup>89</sup> dhe dosjen gjyqësore nr. \*\*\*, datë 29.12.2003, me kërkuese S.D. me objekt “korrigjim datëlindjeje<sup>90</sup>”, Komisioni vëren se çështjet në fjalë janë gjykuar nga gjyqtarë të tjerë dhe jo nga subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj.

### **24.3 Çështja me paditës I.C., i paditur INSIG sh.a., palë e tretë H.H. me objekt “anulim i vendimit administrativ nr. \*\*\*, datë 29.1.2001, të INSIG Dibër” etj., e gjykuar nga gjyqtarja Flora Hajredinaj**

**24.3.1** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2003, ka vendosur: “Anulimin e aktit nr. \*\*\*, datë 29.1.2001, të të paditurit INSIG-Dibër si i pambështetur në ligj dhe prova”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim dega INSIG-Dibër në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.12.2003, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 5.2.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me trup tjetër gjykues” me arsyetimin se janë shkelur rëndë rregullat procedurale, që e bëjnë vendimin e pavlefshëm.

**24.3.2** Komisioni vëren se në vendimin e Gjykatës së Apelit është evidentuar se:

- seanca e datës 5.2.2003 është zhvilluar në mungesën e të gjitha palëve dhe në këto rrethana gjykata nuk duhej të merrte vendim për t’u tërhequr në dhomën e këshillimit për të marrë vendimin;
- disa seanca dhe seanca e fundit janë zhvilluar në mungesë të palës së tretë pa pasur dijeni për datën dhe orën e gjykimit. Gjykata ishte e detyruar t’i njoftonte palët sa herë që bënte shtyrjen e seancave;
- gjykata duhej të merrte mendimin e specializuar të një eksperti të paanshëm kur për zgjidhjen e drejtë të çështjes kërkohet mendimi shkencor dhe jo të bëjë vlerësim vetë.

Në lidhje me këto problematika, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, e cila në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se çështja në fjalë nuk duhet të ndikojë në vlerësimin e aftësive profesionale pasi shtrihet jashtë afatit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016<sup>91</sup>. Subjekti ka shpjeguar se gjykata nuk është tërhequr për vendim datë 5.2.2003, por në datën 3.2.2003, në prani të paditësit dhe të të paditurit në mungesë (në bazë të vendimit përkatës) të palës së tretë. Në lidhje me zhvillimin në mungesë të palëve pa pasur ata dijeni, ky konstatim i Gjykatës së Apelit nuk qëndron pasi nga materialet e dosjes rezulton që palët janë njoftuar dhe kanë pasur dijeni për gjykimin, ndërsa për palën në mungesë është marrë vendimi i mungesës. Në lidhje me caktimin e ekspertit, paditësi ka hequr dorë nga

---

ish-kooperativën bujqësore ...” dhe person i tretë Dega Sigurimeve Shoqërore Dibër, çështje e gjykuar nga gjyqtari H. V., i cili ka pranuar kërkesën e kërkueses F.I.

<sup>89</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka konfirmuar se nuk u arrit të gjendej një dosje e tillë në vitin 2003, por u gjend ajo e vendimit nr. \*\*\*, datë 24.6.2002 me të arrestuarin Sh.D. me të dhënat: Kërkuës - Prokuroria e Rrethit Dibër, i arrestuar – Sh.D., objekt-vleftësim si të ligjshëm i arrestit në flagrancë etj., i akuzuar se ka kryer veprën penale të kontrabandës, vepër e parashikuar në nenin 174 të Kodit Penal. Kjo çështje është gjykuar nga gjyqtari S. N., i cili në vendimin e tij ka vendosur: vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit Sh.D.

<sup>90</sup> Gjykata ka konfirmuar se në lidhje me këtë dosje, nga verifikimet nuk u arrit të gjendej dosje e tillë me këtë numër, datë vendimi e objekt, por u gjend dosja e vendimit nr. \*\*\*, datë 29.12.2003, me kërkuese S.D. me objekt “vërtetimin gjyqësisht për pavërtetësi të pjesshëm të aktit të lindjes sime për datën e muajin e lindjes dhe çështja gjyqësore e vendimit nr. \*\*\*, datë 10.11.2003, me paditës S.D., i paditur - zyra e gjendjes civile T., M.D., me objekt - vërtetimin gjyqësisht për pavërtetësi të pjesshme të gjykuar nga subjekti Flora Hajredinaj, e cila në përfundim ka vendosur: *pranimin e padisë së S.D. për pavërtetësinë e aktit të lindjes së paditëses S.D. dhe vërtetësinë e lindjes së paditëses datë 26.3.1987*. Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me këtë dosje. Ndërsa çështja gjyqësore me paditës S.D., e paditur - zyra e gjendjes civile, objekti-korrigjim i datëlindjes sime nga 11.11.1988 në 26.3.1987, gjykuar nga gjyqtari H. V., për të cilin paditësja hoqi dorë.

<sup>91</sup> Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim.

pjesa e objektit të padisë që lidhet me vlerën që kërkon të dëmshpërblehet dhe kërkoi gjykimin vetëm në lidhje me anulimin e aktit dhe, për këtë arsye, nuk është çmuar thirrja e ekspertit.

**24.3.3** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe të sakta në lidhje me konstatimet e mësipërme. Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në dosje, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë njoftimet e palëve në seancat përkatëse dhe deklarimin e mungesës për personin e tretë. Gjithashtu, ka rezultuar se në një seancë gjyqësore datë 24.1.2003, paditësi ka kërkuar pakësim të objektit të padisë që kishte lidhje me aktekspertimin (pasi gjykata kishte caktuar një të tillë) dhe gjykata, me vendim, vendosi të revokojë thirrjen e ekspertit pasi nuk ishte i nevojshëm për procesin. Subjekti ka zhvilluar seancën gjyqësore në prani të palëve dhe në mungesë të personit të tretë, si dhe ka caktuar seancën tjetër për shpalljen e vendimit.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë çështje gjyqësore dhe, për rrjedhojë, nuk konstatohen shkelje që mund të kualifikohen si problematika që ngarkojnë subjektin me përgjegjësi për kriterin profesional.**

#### **24.4 Në lidhje me dosjen gjyqësore me palë paditëse K.S. kundër Bashkisë Dibër**

**24.4.1** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër konfirmon se nga verifikimi rezulton çështja gjyqësore me paditës K.S. me të paditur Bashkia Peshkopi me objekt: “detyrim i të paditurit për likuidim shume [.....] etj.”. Kjo çështje është gjykuar nga gjyqtarja Flora Hajredinaj.

**24.4.2** Komisioni ka konstatuar se:

- Në zbatim të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, gjyqtarja e çështjes, subjekti Flora Hajredinaj, duhet të kishte kërkuar nga paditësi të saktësonte objektin e padisë referuar shumë të kërkon të paguhet nga i padituri pasi, në kërkesëpadi paditësi kërkon pagesën e detyrimit në shumën 2,853,291 lekë. Në procesverbalin e gjykatës datë 15.4.2003, paditësi pretendon pagimin e detyrimit nga i padituri Bashkia Peshkopi në shumën 3,599,291 lekë, ndërsa në kontratë është i përcaktuar detyrimi prej 3,244,291 lekësh.

- Në procesverbalin e datës 15.4.2003 i padituri ka kërkuar nga gjykata të caktohet një ekspert për të përcaktuar saktë pjesën e llogaritjes së interesit 0.01%, kërkesë kjo që është bërë edhe në seancën përgatitore nga i padituri, por gjykata nuk është shprehur në lidhje me këtë kërkesë të palës në gjykim.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në seancën gjyqësore të datës 15.4.2003, paditësi ka saktësuar vlerën e detyrimit që është 3,599,291 lekë, janë bërë rakordimet përkatëse dhe nga i padituri Bashkia Peshkopi është pranuar detyrimi po në këtë vlerë. Subjekti thekson se saktësimi i objektit të padisë nuk është bërë me shkrim nga paditësi, por verbalisht në seancë dhe parashtrimi i tij është pasqyruar në procesverbal. Ndërsa për sa i përket çështjes së ekspertit, subjekti ka shpjeguar se po në seancën e datës 15.4.2003 paditësi ka kërkuar ekspert për përcaktimin e vlerës së kushtit penal, por meqë seanca është shtyrë menjëherë për shkak të një shqetësimi familjar të paditësit, nuk u arrit të merrej vendim nga gjykata. Në vijim, në seancat e radhës nuk është kërkuar nga paditësi thirrja e ekspertit kur është pyetur nga gjykata, nëse dëshiron të paraqiste prova të tjera, kështu dhe gjykata nuk ka pasur pse të shprehej me vendim për caktim eksperti.

**24.4.3** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me caktimin e ekspertit, ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Komisioni ka analizuar dhe dokumentacionin e dosjes përkatëse dhe vlerëson se qëndron shpjegimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me çështjen e saktësimin të vlerës së detyrimit në padinë e paraqitur në gjykatë, pas analizimit të dokumentacionit, Komisioni vëren se edhe pse paditësi bëri saktësimin e vlerës së

detyrimin verbalisht në seancë gjyqësore, ky është veprim procedural dhe subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtarit të çështjes, duhet të shprehet me vendim të ndërmjetëm që pranonte kërkesën e paditësit për saktësimin e vlerës së padisë, vendim ky që duhet të ishte pasqyruar në procesverbalin përkatës sipas nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile “vendimet e ndërmjetme<sup>92</sup>”.

**Komisioni vlerëson se mospasqyrimi në procesverbal i vendimit të ndërmjetëm që subjekti duhet të merrte kur paditësi bëri saktësimin e objektit të padisë, nuk përbën shkak autonom për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, por mbetet një element, i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.**

## **DENONCIME NGA PUBLIKU**

**25.** Për subjektin e rivlerësimit janë depozituar 5 denoncime nga publiku.

**25.1 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2018,** i shtetases M. H., e cila ankohet se trupa gjyqësore, ku anëtare është edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, në lidhje me çështjen e vëllait të saj, ka dhënë një vendim të padrejtë, të pabazuar në prova dhe fakte, trupa ka dhënë vendim për heqje lirie 20 vjet për vëllain e saj, i cili ishte i pafajshëm dhe ngjarja ishte aksidentale dhe nuk mund të cilësohet si vrasje me dashje.

**25.2 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2019,** i shtetasit V. Ç., i cili ankohet ndaj disa subjekteve dhe subjektit Flora Hajredinaj, si dhe ka bashkëngjitur vendime gjyqësore të subjekteve të përmendura dhe të subjektit Flora Hajredinaj, por nuk ka përcaktuar ankesën, rrethanën specifike në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

**25.2.1** Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve, themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit dhe, për këtë qëllim, Komisioni mban parasysh nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.

**25.3 Denoncimet/ankesat nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2019,** të shtetasit P. Dh., i cili ankohet ndaj subjektit Flora Hajredinaj për shkelje procedurale të kryera prej saj dhe trupës gjyqësore me 5 anëtarë që kanë të bëjnë me zgjatje të seancës paraprake tej afateve, mosnjohim të seancave në adresën e vendbanimit dhe shkelje të afatit 10-ditor të njoftimit të seancës, etj.

**25.4 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2019,** i shtetasit K. S., i cili ankohet ndaj subjektit Flora Hajredinaj dhe trupës gjyqësore për shkelje procedurale të kryera në një çështje, ku ka qenë palë (pretendime me denoncuesin P. Dh., pasi kanë qenë bashkë të pandehur të së njëjtës çështje).

**25.5** Komisioni, në lidhje me këto denoncime, administroi dosjen në fjalë nga Gjykata e Krimeve të Rënda<sup>93</sup> dhe pasi analizoi dokumentacionin në dosje konstatoi se pretendimet e dy denoncuesve (pasi ishin bashkë të pandehur në të njëjtën çështje) nuk qëndrojnë për arsyet, si vijon:

i) procesi gjyqësor ka filluar me seancën e parë më 27.11.2018 dhe ka përfunduar datë 1.4.2019, kur u mor vendimi i dërgimit të çështjes në gjyq dhe ka zgjatur për një periudhë 5-mujore. Kjo zgjatje nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive nga gjyqtarja, por për shkaqe objektive të procesit (të pamundësive të mosmarrjes dijeni të të pandehurve edhe pse janë njoftuar nga gjykata), mungesës së prokurorit, si dhe për plotësim të hetimeve nga prokuroria;

<sup>92</sup> Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij kodi.

<sup>93</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2020, nga Gjykata e Krimeve të Rënda.

ii) gjyqtarja Flora Hajredinaj ka realizuar njoftimet e prokurorisë dhe të të pandehurve në gjykim për çdo seancë, njoftim i realizuar me shërbimin postar ashtu dhe me anë të Komisariateve të Policisë që mbulojnë adresat e të pandehurve që pas dy seancash është bërë i mundur njoftimi i tyre;

iii) në dosjen gjyqësore nuk gjenden kërkesa të të pandehurve për përjashtim të gjyqtares, referuar pretendimit se gjyqtarja duhet të dorëhiqej me pretendimin se kallëzuesi ishte nga i njëjti vend me vendlindjen e gjyqtares;

iv) pretendimi se gjyqtarja ka pranuar prova të rreme të prokurorisë nuk qëndron pasi gjykata ka vlerësuar në tërësi të gjitha provat e depozituara nga prokuroria dhe, më pas, e udhëhequr nga bindja e brendshme ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se çështja duhej dërguar për gjykim;

v) pretendimi që edhe pse seancat kanë qenë me dyer të mbyllura dhe konfidenciale dhe se konfidencialiteti nuk është respektuar nga gjykata, pasi pretendohet se këto seanca janë publikuar nga media dhe nga gjykata nuk u bë e mundur ruajtja e tij, nuk provohet që informacionet të jenë nxjerrë nga gjykata.

**Komisioni arrin në përfundimin, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.**

## **V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT**

Trupi gjyqësor, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj:

- Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe të saktë të pasurisë.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti, me të ardhurat e përfituara nga punësimi i saj dhe i personit të lidhur me të, si dhe huat dhe dhuratat, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës, të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016, vetëm në vitin 2008 në shumën -222,967 lekë, të cilën Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit, e vlerëson si të papërfillshme, duke mos prodhuar pasoja të tilla që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nga vlerësimi i secilit prej tri kriterëve:

- a. ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë në vlerësim tërësor, duke përbushur kushtet ligjore të germës “a”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
- c. konsiderohet “i aftë” në vlerësimin e aftësive profesionale, duke përbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, si dhe në bazë të pikës 1/a, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Hajredinaj, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Vendimi, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.12.2020

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
Kryesuese

**Olsi KOMICI**  
Relator

**Firdes SHULI**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*